

Të drejtat e minoriteteve nën qeverisjen ndërkombëtare

Nga Clive Baldwin

Falënderime

Grupi Ndërkombëtar për të Drejtat e Minoriteteve (MRG) falënderon për përkrahjen të gjitha organizatat dhe individët që dhanë asistencë financiare dhe asistencë tjetër për përgatitjen e këtij raporti, përfshi këtu DfID (Departamenti i MB-së për Zhvillim Ndërkombëtar). Redaktor i raportit: Sophie Richmond.

Autori:

Clive Baldwin është Shef i Avokimit në Grupin Ndërkombëtar për të Drejta të Minoriteteve. Nga viti 2000 deri më vitin 2002 ka qenë anëtar i Misionit të OSBE-së në Kosovë. Para kësaj, ka punuar si jurist për të drejta të njeriut.

Grupi Ndërkombëtar për të Drejta të Minoriteteve (MRG)

Grupi Ndërkombëtar për të Drejta të Minoriteteve (MRG) është organizatë joqeveritare (OJQ) që punon për të siguruar të drejtat e minoriteteve etnike, fetare dhe gjuhësore dhe popujve vendas nëpër botë, dhe për të promovuar bashkëpunim dhe mirëkuptim ndërmjet komuniteteve. Aktivitetet tona fokusohen në avokimin ndërkombëtar, trajnime, publikime dhe këshillime. Ne udhëhiqemi nga nevojat që shprehen nga ana e rrjetit botëror të organizatave tona partnere, të cilat përfaqësojnë minoritetet dhe popujt vendas.

MRG punon me mbi 150 organizata në afër 50 vende. Këshilli ynë udhëheqës, i cili takohet dy herë në vit, është i përbërë prej anëtarëve nga 10 vende të ndryshme. MRG posedon status konsultativ me Këshillin Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara (ECOSOC), dhe status vëzhgues në Komisionin Afrikan për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve (ACHPR). MRG është e regjistruar si organizatë humanitare dhe kompani e limituar me garancion sipas ligjit anglez. E regjistruar si organizatë humanitare nr: 282305, si kompani e limituar nr. 1544957

© Minority Rights Group International 2006

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Materiale nga ky publikim mund të riprodhohen për qëllime mësimdhënieje ose për qëllime tjera jokomerciale. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet në asnjë formë që ka për qëllim përfitime komerciale pa lejen paraprake të bartësit të të drejtës së autorit.

Për informata plotësuese ju lutemi kontaktoni MRG-në. Një CIP katalog i këtij publikimi është i qasshshëm në Librarianë Britanike.

ISBN 1 904584 46 2. Publikuar Korrik 2006. Typeset by Kavita Graphics. Printuar në MB në letër të recikluar. Fotografia në ballinë: Mëhalla rome në Mitrovicë Qershor 2006. Të drejtat e minoriteteve në Kosovë nën qeverisjen ndërkombëtare është publikuar nga MRG si kontribut për të kuptuar çështjen që është temë e këtij publikimi. Teksti dhe pikëpamjet e autorit nuk përfaqësojnë pikëpamjen kolektive të MRG-së çdoherë dhe në çdo detal të tij.

Shkurtesat

COMKFOR	Komandanti i KFOR-it
DPKO	Departamenti i KB-së për Operacione Paqeruajtëse
EAR	Agjencioni Evropian për Rikonstruim
ERRC	Qendra Evropiane për të Drejta të Romëve
UE	Unioni Evropian
KKDM	Konventa Kuadër për Mbrojtjen e të Drejtave të Minoriteteve
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
KLMK	Komisionari i Lartë për Minoritetet Kombëtare (OSBE)
DBP	Drejtoria për banim dhe pronësi
KPA	Këshilli i Përkohshëm Administrativ
PZHP	Persona të zhvendosur përkohësisht
KPK	Komiteti i Përbashkët për Kthimin e serbëve të Kosovës
SPPA	Struktura e Përbashkët e Përkohshme Administrative
KFOR	Forcat e KFOR-it
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
MVK	Misioni Verifikues i Kosovës
MRG	Grupi Ndërkombëtar për të Drejtat e Minoriteteve
NATO	Organizata e Paktit Veriatlantik
OJQ	Organizata Joqeveritare
ZKLDNJ	Zyra e Komisionarit të Lartë për të Drejta të Njeriut
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
IPVQ	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
RAE	Romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit
RSFJ	Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë
PSSP	Përfaqësuesi i Përgjithshëm i Sekretarit të Përgjithshëm
KB	Kombet e Bashkuara
DKBM	Deklarata e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e të Gjithë Personave që u Takojnë Minoriteteve Etnike, Fetare dhe Gjuhësore
UNHCR	Zyra e Komisionarit të Lartë të KB-së për Refugjatë
UNIFEM	Fondi Zhvillimor i KB-së për Femrat
UNMIK	Misioni i KB-së në Kosovë
UNOSEK	Zyra e Sekretarit Gjeneral të KB-së për procesin e ardhshëm të statusit të Kosovës

Përmbledhje

Askund në Evropë nuk ka një segregacion të atillë si në Kosovë. Me mijëra njerëz janë ende të zhvendosur dhe qëndrojnë nëpër kampe. Askund tjetër nuk ka aq shumë qytete dhe fshatra “etnikisht të pastra” të shpërndara në një provincë aq të vogël. Askund tjetër nuk ka një nivel të tillë të frikës në mesin e minoriteteve se ata mund të malltretohen, thjeshtë për faktin se kush ata janë. Dhe, si duket, askund në Evropë nuk ka një rrezik aq të lartë për pastrim etnik në një të ardhme të afërt – ose bile dhe një rrezik nga gjenocidi.

Kjo nuk është një përshkrim i Kosovës së vitit 1998 ose 2003. Është një përshkrim i Kosovës sot. Për serbët dhe “minoritetet tjera” – romët, boshnjakët (myslimanët sllavë), kroatët, turqit dhe shqiptarët e Kosovës – të cilët vuajnë nga përzënia nga shtëpitë e tyre, diskriminimi dhe restriksionet në të folurit e gjuhës së tyre, shembulli i dhunës të cilën e kanë duruar për aq gjatë mund të vendoset mirë si një ligj në Kosovën e re, ashtu si që bisedimet për statusin e ardhshëm vazhdojnë pas dyerve të mbyllura në Vjenë. Si është lejuar që të ndodhë kjo, pas njëres nga administratat më të gjata dhe më të shtrenjta ndërkombëtare që prej krijimit të Kombeve të Bashkuara (KB), mandati i së cilës ka qenë eksplicit, të sigurojë një mjedis që refugjatët të kthehen në shtëpitë e tyre dhe të mundësojë siguri publike (Rezoluta 1244, Neni 10)?

Ky raport ndjek një dështim të qartë në pjesën e protektoratit ndërkombëtar për të mësuar leksionet nga e kaluara dhe të mbështetet në ekspertizën mbi të drejtat e minoriteteve që është e disponueshme në trupat e KB-së dhe trupa të tjera. Ky dështim i ka lejuar vendimmarrësit të mbesin të papërgjegjshëm, dhe ka prodhuar një Kornizë Kushtetuese që i referohet të drejtave të minoriteteve aq gjerësisht sa që janë tepër të gjera për të qenë efektive. Në vend të integritetit, situata aktuale inkurajon të kundërtën: segregacionin. Raporti tregon se si struktura fillestare ndërkombëtare – pesë brigada të ndryshme të armatosura në Kosovë, secila prej tyre e vendosur në rajon të ndryshëm dhe e udhëhequr nga një shtet i ndryshëm (Franca, Gjermania, Italia dhe MB dhe SHBA), secila prej tyre me polici shumë të ndryshme në raport me sigurinë dhe minoritetet – i ka mbajtur të freskëta plagët e shkaktuara para se të vinin për herë të parë forcat e armatosura dhe para se të lejonin që shembujt e dhunës të ripërsëriteshin.

Problemi nuk qëndron në mungesën e financave. Në të kundërtën, fakti se janë shpenzuar aq shumë para në rajon ka lejuar segregacion në shërbimet publike për t’u shndërruar në një solucion të lehtë të konfliktit ndërmjet grupeve. Mentaliteti afatshkurtër, përdorimi i sistemit të kuotave në shërbimet publike dhe një sistem zgjedhor i bazuar në përfaqësimin strikt etnik tregojnë një mungesë të përkushtimit për implementim të të drejtave të minoriteteve në çfarëdo mënyre domethënëse.

Ky raport tregon se si negociatat për statusin e ardhshëm që janë duke u zhvilluar në Vjenë përfaqësojnë edhe shpresën më të mirë edhe rrezikun më të madh për paqen.

Në mënyrë që të arsyetohet shpresa, ky raport thekson se ekziston një nevojë radikale për ndryshim në mënyrën e të menduarit dhe në praktikë:

- Të drejtat e minoriteteve duhet të garantohen nga një qeverisje e së drejtës e cila me të vërtetë do të kuptohet dhe do të aplikohet seriozisht.

Deri më sot, administrata qeverisëse, Misioni i KB-së në Kosovë (UNMIK) dhe forcat e KFOR-it të udhëhequra nga NATO kanë deklaruar vetveten mbi rregullat, duke i kthyer mbrapsht bile edhe ligjet më bazike të të drejtave të njeriut, si që është për shembull rasti me kërkesën që të gjitha paraburgimet të bëhen vetëm me

një vendim të gjykatësit. Të drejtat që ekzistojnë në letër janë bërë jodomethënëse dhe momentalisht është duke u minuar çdo kuptim i brishtë i sigurisë që kanë minoritetet. Prandaj:

- Sistemi i drejtësisë penale medoemos duhet t'i mbajë të përgjegjshëm ata që kanë kryer krime në të kaluarën dhe t'i arrestojë pa marrë parasysh pushtetin politik që ata mund ta kenë.

Nga qindra hetime që janë bërë deri me rastet e dhunës së vitit 2004, vetëm disa prej tyre janë përndjekur, ndërsa ato pak që janë dënuar kanë marrë dënime të lehta.

- Në vend të bisedimeve sekrete dhe prapa dyerve të mbyllura ndërmjet një grupi të selektuar të njerëzve duhet të konsultohen të gjitha minoritetet mbi të ardhmen e jetëve të tyre, pronën dhe vendin e tyre.
- Duhet të ndërmerren përpjekje specifike për të përfshirë pikëpamjet e femrave ndërsa negociatat ndërkombëtare duhet të përfshijnë ekspertë të të drejtave të minoriteteve dhe ekspertë gjinorë.

Në kohën kur u përpilua Korniza Kushtetuese në vitin 2001, ajo nuk u vendos pata konsultimeve të përgjithshme. I njëjti gabim është duke u bërë edhe sot, duke pasur bisedime në Vjenë, shumë larg nga vendi ku personat e disfavorshëm mund të marrin pjesë. Të kuptuarit e realitetit dëshpërues që përfshin kthimin e refugjatëve dhe komunitete që dëshirojnë të mbajnë gjallë gjuhën e tyre, të udhëtojnë në siguri dhe të kërkojnë punë në të gjitha nivelet e shoqërisë – të gjitha këto gati se janë bëtë të pamundshme për minoritetet e Kosovës edhe përkundër shtatë viteve të intervenimit ndërkombëtar – është vital për cilindo që është i involvuar në misione paqeruajtëse, në raportime ose në qeverisje ndërkombëtare. Raporti tregon se masat që i ndajnë komunitetet përmes fesë ose etnicitetit duhet të jenë tranzicionale, nëse tek e fundit është e domosdoshme që ato të përdoren. Bisedimet për statusin e ardhshëm ofrojnë një shans për ndryshim. Përndryshe, ekziston rrezik që shembuj të segregacionit që janë pranuar në Kosovë, dhe që çojnë kah terrori i pastrimit etnik, do të përfshihen në Kushtetutë, dhe do të përsëriten sërish edhe gjatë dekadës së ardhshme.

Parathënie

Në vitin 1999, Kombet e Bashkuara e morën administrimin e Kosovës duke vendosur të drejtat e minoriteteve në thelb të mandatit të tyre. Sot, në fillimin e negociatave për statusin e ardhshëm, Kosova mbetet një shoqëri thellësisht e ndarë dhe fizikisht e segreguar. Kosova jep sfida të rëndësishme, dhe gjithashtu edhe mundësi për të përmbushur garancitë e të drejtave të njeriut dhe premtimet e bashkëpunimit ndërkombëtar. Deri në realizimin e këtyre premtimeve ne medoemos duhet të sjellim aplikimin më të besueshëm të mësimave të mësuara gjatë dekadave të mëparshme të eksperiencës me fuqizimin e të drejtave, ndërtimin e paqes dhe rikonstruimin postkonfliktuoz. Testi që ofron Kosova është gjithashtu një sfida për makinerinë ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe, më konkretisht, të drejtave të minoriteteve.

Atje ku tensionet etnike dhe dhuna ndajnë shoqëritë, si që është rasti në Kosovë, respektimi i të drejtave të minoriteteve avancohet kushtet për stabilitet politik dhe social dhe për paqe. Në vend të promovimit të segregacionit dhe separacionit, të drejtat e minoriteteve bazohen në parimin e një shoqërie të integruar, ku secili mund të përdorë gjuhën e vet, të gëzojë kulturën e vet dhe të ëpraktikojë fenë por përsëri të ndihet si pjesë e identitetit më të gjerë dhe përfshirës nacional. Në shoqëri të këtilla, grupe të ndryshme nacionale, etnike, fetare dhe gjuhësore janë në mundësi të jetojnë bashkë, të komunikojnë efektivisht, dhe të kuptojnë vlerën në dallimet ndërmjet veti dhe të diversitetit kulturor në shoqëritë e tyre.

Qendrore në mandatin tim si Ekspert i Pavarur i KB-së për Çështje të Minoriteteve është Deklarata e KB-së për të Drejtat e Personave që u Takojnë Minoriteteve Kombëtare ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore. Kjo deklaratë, bashkë me standardet e aplikueshme rajonale dhe ndërkombëtare mbi të drejtat e minoriteteve, ofron mjetet esenciale normative prej të cilave mund të dalin solucione të vonuara. Ato ofrojnë obligime dhe udhëheqje në fushën e të drejtave të minoriteteve, por gjithashtu, pasi të përfshihen në kornizën kushtetuese dhe legjislativë ato ofrojnë edhe një bazë të fortë mbi të cilën mund të ndërtohen shoqëritë. Si të tilla, në veten e tyre, këto standarde nuk janë të mjaftueshme; ato kërkojnë përkushtim, leadership dhe iniciativa kreative për të shndërruar parimet në realitet.

KB-të dhe organizata të tjera ndërqeveritare që janë duke punuar në Kosovë, duhet të implementojnë më me efektivitet standardet e të drejtave të njeriut dhe qasjet e bazuara në të drejta të njeriut. Unë përshëndes emërimin e Marti Ahtisaari-t, ish kryetar i Finlandës, për udhëheqjen e bisedimeve për statusin e ardhshëm dhe besoj që ai do të luajë një rol esencial në krijimin e strategjive konstruktive dhe kolaborative të angazhimit dhe qasje përfshirëse në negociatat në vijim.

Komunitetet e ndryshme etnike, fetare dhe gjuhësore në Kosovë duhet të kuptojnë se zgjidhjet qëndrojnë në duart e tyre aq sa zgjidhjet janë përgjegjësi e qeverive dhe komunitetit ndërkombëtar, dhe të bëjnë përpjekje intensive për të tejkaluar ndarjet aktuale. Vullneti politik për arritjen e drejtësisë dhe zgjidhjeve të qëndrueshme duhet të demonstron nga e tërë shoqëria civile, si dhe nga shtetet dhe aktorët ndërkombëtar. Vullneti politik për respektim të të drejtave dhe vlerësim të kontributit të të gjithëve është një komponentë esenciale e shoqërive funksionuese, të shëndosha dhe prosperuese: vullneti për të biseduar, për të ndarë, për bashkëpunim, për përfshirje dhe participim; vullneti për ndërtim të urave dhe thyerjen e barrierave ndërmjet komuniteteve, pa marrë parasysh se sa të thella janë bërë ato barrierat. Pa një vullnet të tillë, edhe përpjekjet më të mira të komunitetit ndërkombëtar asnjëherë nuk do të kishin qenë të mjaftueshme.

Nuk ka zgjidhje të lehta për problemet në Kosovë; megjithatë, ekzistojnë rrugë që ofrojnë potencial shumë të madh për përfshirje, paqe, stabilitet dhe zhvillim. Këto rrugë doemos duhet të mohojnë segregacionin dhe pastrimin etnik, dhe të përfshijnë qeverisjen e së drejtës dhe të drejtat e minoriteteve. Alternativa është një e ardhme me ndarje të vazhdueshme, jobesim dhe josiguri, që ka një potencial jo vetëm për të sjellë edhe një herë vuajtje dhe konflikt për jetët e popujve në Kosovë, por gjithashtu që edhe më tepër të provokojë tensionet në një rajon që ka vuajtur shumë nga pasojat destruktive të nacionalizmit dhe diskriminimit.

Unë e përshëndes këtë raport të Grupit Ndërkombëtar për të Drejtat e Minoriteteve si mjaft të rëndësishëm dhe të nevojshëm për këtë periudhë, duke ofruar një analizë reale vitale dhe të dobishme të progresit të bërë deri më tani në rrugën e vështirë të një Kosove të re. Një mesazh kyç i këtij raporti është nevoja për konsultime dhe participim domethënës të të gjitha komuniteteve të Kosovës, një mesazh të cilin unë e përmbaj tërësisht.

Raporti gjithashtu jep një vlerësim shumë të nevojshëm të rolit esencial të të drejtave të minoriteteve, dhe një drejtim në sigurimin se ata do të gjejnë vendin e tyre në kornizën e ardhshme ligjore të Kosovës, cilido qoftë rezultati i negociatave për statusin e ardhshëm.

Gay McDougall

Ekspert i Pavarur i KB-së për Çështje të Minoriteteve

Hyrje

'Ne nuk mund të lejojmë e keqja e pastrimit etnik të qëndrojnë. Ne nuk duhet të pushojmë deri sa ajo të zhduket.'

(Tony Blair, fjalim për Kosovën, prill 1999)

'Norma të ndryshme të avancuara ... janë vendosur për të prekur një pjesë të madhe të çështjeve të komuniteteve minoritare. Megjithatë, realiteti i Kosovës mbetet shumë larg nga këto norma dhe plane të zëshme.'

(Komiteti Këshillëdhënës i Këshillit të Evropës për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, nëntor 2005)

Në vitin 1999 Organizatat e Paktit Veri-Atlantik (NATO) shkoi në luftë për të drejtat e një minoritetit – shqiptarët e Kosovës, brenda Republikës Federale Jugosllave (RFJ). Që nga qershori 1999, Kosova është qeverisur nga një administratë e përkohshme e udhëhequr nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) duke përfshirë këtu Unionin Evropian (UE) dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). Një “prezencë sigurie”, e quajtur KFOR (Forcat e Kosovës), udhëhiqet nga NATO dhe përfshin ushtarë nga të paktën 30 vende anëtare dhe joanëtare të NATO-s. Mijëra zyrtarë ndërkombëtarë kanë punuar në Kosovë, dhe me miliona euro janë harxhuar në Kosovë. Tani duke iu afruar përvjetorit të saj të shtatë, kjo administratë është njëra nga administratat ndërkombëtare më të shtrenjta dhe më të gjata që nga krijimi i Kombeve të Bashkuara (KB).

Protektorati ndërkombëtar lindi në rrethana në të cilat ishte e qartë se prioriteti i saj më i rëndësishëm do të ishte të sigurojë harmoni dhe bashkëpunim në mes grupeve të ndryshme etnike, d.m.th. siguri për mbrojtje të plotë të të gjitha të drejtave të këtyre grupeve, veçanërisht të minoriteteve. Parë në letër, do të na dukej se Kosova do të duhej të ketë qenë e bekuar për shkak se administrohet nga institucione me një histori të gjatë të punës në mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve, si që janë KB-të, të cilat në vitin 1992 u dakorduan për një Deklaratë mbi të Drejtat e të Gjithë Personave që u Takojnë Minoriteteve Kombëtare ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore (DKBM). KB-të kanë një Grup Punues për Minoritetet që mblidhet në Gjenevë çdo vit dhe jep këshilla dhe opinione speciale mbi të drejtat e minoriteteve. OSBE në vitin 1992 themeloi Komisionarin e Lartë për Minoritete Kombëtare (KLMK) i cili ka zhvilluar ekspertizë të paparë në përdorimin dhe aplikimin e standardeve për të drejtat e minoriteteve të pranuar ndërkombëtarisht në mënyrë që të parandalojë konflikte. Me resurset e vendosura në Kosovë, mund të pritët që të drejtat e minoriteteve janë plotësisht të mbrojtura. Në vend të kësaj, pas gati shtatë viteve në ekspertizës ndërkombëtare, situata e minoriteteve në Kosovë në vitin 2006 është katastrofale. Me arritjen e forcave dhe administratës ndërkombëtare në vitin 1999 u pa një dallgë e madhe që mund të përshkruhet vetëm si pastrim etnik: sulme të targetuara në minoritetet për t'i përzënë ata nga shtëpitë e tyre. Rezultati ishte largimi nga Kosova i shumicës së serbëve, dhe zhvendosja e një numri të madh të romëve dhe shqiptarëve (këto të fundit nga zonat serbe). Pesë vite më pas, në vitin 2004, ky shembull u përsërit. Sot, me mijëra persona të minoriteteve në Kosovë nuk janë në gjendje të jetojnë në shtëpitë e tyre. Në mbrojtjen e përditshme të të drejtave bazike të minoriteteve – të drejtës së çdokujt të jetojë në një shoqëri ku mund të flasë në gjuhën e vet, dhe të praktikojë kulturën dhe fenë e vet lirshëm pa mos vuajtur nga ndonjë e keqe – Kosova ka arritur të drejta vetëm në letër. Ky trend ka sjellë një segregacion gjithnjë e më të madh në mes të shqiptarëve dhe serbëve, bile edhe në nivel të

fshatrave, ndërsa të gjitha grupet tjera janë marginalizuar pa masë. Bisedimet mbi statusin e ardhshëm të Kosovës nuk kanë sjellë ende asnjë ide për zgjidhjen e kësaj situatë.

Është e qartë se diçka nuk ka shkuar si duhet. Të kuptuarit se si administrata ndërkombëtare dështoi në të kuptuarit dhe aplikimin e të drejtave të minoriteteve është kritike për dy arsye. E para, është e rëndësishme për të ardhmen imediate të Kosovës. Çfarëdo që të jetë statusi i ardhshëm, diskutimet doemos të përfshijnë një strukturë që do të sigurojë se të drejtat e minoriteteve do të implementohen tërësisht, dhe kështu do t'ju lejojnë të gjithëve që të jetojnë lirshëm duke mësuar nga gabimet e shtatë viteve të kaluara. Megjithatë, gjithashtu është shumë vitale për ruajtjen e paqes në të ardhmen që ata që janë të involvuar në misione ndërkombëtare të mësojnë përsa KB dhe OSBE nuk i kanë përdorur njohuritë e tyre mbi të drejtat e njeriut në një mision të tillë kritik.

Histori e shkurtër e Kosovës

Kosova, një rajon prej përafërsisht 11.000 km² dhe me një popullatë prej 2 milionë, si pjesa më e madhe e Evropës juglindore, është e banuar nga më shumë grupe etnike, gjuhësore dhe fetare. Shumë ngjyrë, dhe në fakt edhe gjak, është derdhur gjatë përpjekjeve të grupeve të ndryshme për të pohuar se ata kanë qenë të parët që kanë banuar një rajon të caktuar dhe prandaj duhet të kenë një pretendim superior (ose ndoshta dhe të vetëm). Në fakt, pretendimet e këtilla janë të pakuptimta, pasi që të gjitha grupet që jetojnë në Kosovë kanë të njëjtat të drejta që të jetojnë të lirë dhe të njëjtat të drejta në participim ekonomik dhe politik. Përveç kësaj, historia është ende e freskët, prandaj duhet marrë parasysh një konsiderim i shkurtër.

Për vite me radhë Kosova ishte pjesë e perandorisë romake dhe bizantine. Në vitin 1000, shqiptarët, që prejardhjen e kanë nga ilirët, kanë jetuar në këto troje, si edhe sllavët (serbet) dhe vllahët. Prej vitit 1200 deri në vitin 1450 Kosova ka qenë pjesë e mbretërisë serbe. Shumë manastire serbe janë gjetur në Graçanicë, Pejë dhe Deçan. Në 28 qershor 1389 ka ndodhur beteja e parë e Kosovës ndërmjet armatës së princit serb L Lazarit (armatat e të cilit përbëheshin nga nacionalitete të rajonit, duke përfshirë edhe shqiptarët, dhe sulltanit otoman Muradit. Edhe pse të dy liderët u vranë, beteja është trashëguar në mitologjinë serbe si një humbje heroike për serbet.

Megjithatë, mbretëria serbe, dhe me të edhe Kosova, nuk u mposht nga otomanët deri në vitin 1455. Kosova ngeli pjesë e perandorisë otomane për 450 vitet e ardhshme, me qeveritarë që flitnin turqisht, dhe gradualisht një pjesë e madhe e popullatës morri fenë islame. Pas një okupimi të shkurtër të Austrisë në vitet 1689-90, riokupimi otoman solli drejt shpërnguljes së serbëve nga ky rajon. Kjo *Velika Seoba* (Shpërngulje e madhe) është një pjesë e rëndësishme e pikëpamjes serbe drejt historisë, dhe shënon pikën kur, sipas të besuarit serb, ata janë bërë minoritet në Kosovë.

Ringjallja nacionale shqiptare zakonisht thuhet se ka filluar me 'Lidhjen e Prizrenit' që ka origjinën nga një takim në Prizren, Kosovë 1878, por u prish nga otomanët brenda tre viteve. Një ngritje tjetër shqiptare ndodhi në vitin 1910.

Në vitin 1912, vilajeti i Kosovës u mposht nga Serbia, Mali i Zi dhe Bullgaria në Luftërat e Para Ballkanike dhe e ndanë midis tyre, duke ia dhënë pjesën më të madhe Serbisë. Pas Luftës së Parë Botërore, Serbia dhe Mali i Zi u bënë pjesë e shtetit të ri të Jugosllavisë. Qeveria jugosllave diskutoi lidhur me dëbimin e popullatës shqiptare nga Kosova.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, pjesa më e madhe e Kosovës u bë pjesë e Shqipërisë së Madhe e kontrolluar nga Italia. Pas dorëzimit të Italisë aleatëve në shtator 1943, rajoni u okupua nga forcat gjermane deri kur u detyruan të tërhiqen nga Armata Sovjetike një vit më vonë. Me mijëra serb u vranë gjatë luftës dhe me mijëra u shpërngulën. Disa prej tyre u privuan nga e drejta të kthehen pas përfundimit të luftës.

Pas Luftës së Dytë Botërore, Tito erdhi në pushtet dhe formoi në vitin 1963 Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ). Në fillim autoritetet në Kosovë kishin shumë pak pushtet, por më vonë gjithnjë e më shumë u jepeshin ingerenca për të udhëhequr me provincën. Në vitin 1974 u shpall Kushtetuta finale e RSFJ-së, e cila gati se i dha autonomi të plotë Kosovës edhe pse në mënyrë nominale ajo mbeti pjesë e Serbisë. Pas vdekjes së Titos në vitin 1980, autoritetet në Prishtinë të dominuar nga shqiptarët kishin një shkallë të lartë të autonomisë. Serbët filluan të ankohen gjithnjë e më fuqishëm për shkak të diskriminimit dhe dëbimit në Kosovë, sidomos pasi shqiptarët demonstruan në vitin 1981 për të kërkuar që Kosova të bëhet republikë e plotë. Shumë ankesa kishte edhe nga të gjitha komunitetet tjera lidhur me atë që zhvillimi ekonomik ishte shumë më i kufizuar në Kosovë në krahasim me pjesën tjetër të vendit.

Në vitin 1987, Slobodan Millosheviqi, në atë kohë një zyrtar pak i njohur i Partisë Komuniste, u bë i njohur duke shkuar në Kosovë dhe duke nxjerr në pah publikisht çështjen e minoritetit serb atje. Kjo e solli atë në pushtet në Serbi. Një rol kyç në përparimin e tij luajti heqja e autonomisë së Kosovës në vitin 1989, duke ia kthyer pushtetin e udhëheqjes me provincën Beogradit. Kjo u shoqërua me diskriminim sistematik kundër shqiptarëve të Kosovës gjatë dekadës së ardhshme në shtetin që tani quhej Republika Federale e Jugosllavisë. Arsimimi në gjuhën shqipe dhe mediumet u reduktuan dukshëm, ndërsa shqiptarët në mënyrë sistematike u lëshuan nga punët shtetërore dhe diskriminoheshin gjatë pranimit në pozicione të reja pune. Shqiptarët e Kosovës u përgjigjën me një lëvizje masovike paqësore, e cila protestoi kundër dhe bojkotoi institucionet shtetërore. U vendosën institucione të ndara, jozyrtare të shqiptarëve, duke përfshirë edhe zgjedhjet të cilat rezultuan me lidërshpin e Ibrahim Rugovës, dhe një sistemi alternativ, jozyrtar të arsimit.

Megjithatë, pas viteve 1988-9, shumë pak vëmendje ndërkombe të kushtua Kosovës. Kështu ishte gjendja edhe kur komuniteti ndërkombëtar ishte i fokusuar në luftërat në veri të Jugosllavisë (në Kroaci, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe një luftë e shkurtër në Slloveni). Kosova injorohet gjatë Marrëveshjeve të paqes të Dejtonit që përfundoi luftën në Bosnjë dhe Hercegovinë në vitin 1995. Komuniteti ndërkombëtar filloi ta vërejë Kosovën vetëm pasi u paraqit 'Ushtria Çlirimtare e Kosovës' (UÇK) me operacionet e saj të cilat sollën deri në një luftë të shkallës së plotë në vitin 1998. Edhe shqiptarët edhe serbët ikën nga Kosova në vitin 1998, edhe pse numrat janë të dyshimtë. Pasi që lufta vazhdoi në vitin 1998, vendet e NATO-s u kërcënuan të bombardojnë Serbinë. Millosheviqi u dakordua për armëpushim me UÇK-në dhe për një prezencë ndërkombëtare të udhëhequr nga OSBE-ja për të bërë monitorimin.

Megjithatë, armëpushimi u theye dhe OSBE-ja raportoi për një valë të re të dhunimeve të të drejtave të njeriut kundër shqiptarëve, posaçërisht në masakrën e Reçakut në janar të vitit 1999. Kjo solli deri në një presion të ri për një marrëveshje ndërkombëtare dhe negociatat e Rambujesë në Francë për t'u përpjekur që ta shtyjnë Millosheviqin që të dakordohet që Kosovës t'i jepet autonomi me mbikëqyrje ndërkombëtare. Këto negociata dështuan dhe NATO filloi bombardimin e RFJ-së në mars të vitit 1999.

Bombardimet vazhduan tre muaj rresht. Gjatë kësaj periudhe me qindra mijëra njerëz, shumica shqiptarë, ikën nga Kosova. Shumica prej tyre thonë se kjo është bërë

për shkak të një politike të qëllimshme të forcave të RFJ-së për pastrim etnik, që formoi një pjesë kyçe të akuzës dhe gjyqimit të Millosheviqit në Tribunalin Ndërkombëtar Penal për Ish-Jugosllavinë (2002-6). Në qershor të vitit 1999, nën presionin rus, Millosheviqi u pajtua që të tërheq forcat dhe zyrtarët e RFJ-së nga Kosova duke i zëvendësuar ata me një administratë ndërkombëtare dhe forca të sigurisë.

Minoritetet në Kosovë

Termi 'minoritet' në Kosovë është edhe më kontraverz se zakonisht. Si që është shpesh rasti, anëtarët e grupeve kanë shumë pak dëshirë që ata të referohen si minoritet, duke pasur si çështje kryesore mundësinë për të jetuar lirshëm, të flasin gjuhën e tyre, dhe të praktikojnë kulturën dhe fenë e tyre. Për serbët, në veçanti, ekziston një frikë se nëse ata referohen si 'minoritet' në Kosovë në të njëjtën kohë pranojnë se Kosova është një shtet i pavarur (pasi serbët nuk janë minoritet në Serbi si shtet i tërë). Për këtë shkak, termi 'komunitet' përdoret më shpesh në Kosovë, dhe ky është termi që përdoret për të drejtat e dhëna me Kornizën Kushtetuese.

Megjithatë, termi 'minoritet' është termi më objektiv. Ky term i referohet një grupi bazuar në nacionalitet, etnicitet, gjuhë ose fe që është minoritar në një lokacion të caktuar. Në *Vlerësimin e Tetë të Situatës së Minoriteteve Etnike në Kosovë*, OSBE-ja dhe Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) tha:

'Edhe pse të vetëdijshëm për kompleksitetin gjithnjë në rritje dhe sensitivitetin që i rrethon çështjet e minoriteteve dhe të vetëdijshëm për tendencën që për komunitetet lokale të flitet si diçka e kundërt prej minoriteteve, ne e kemi ruajtur strukturën dhe terminologjinë e raporteve të mëparshme. Kjo nuk është bërë nga josesensitiviteti por për shkak të efikasitetit. Prandaj, ne vazhdojmë të përdorim frazën minoritet dhe përdorimi thjeshtë i referohet cilitdo komunitet që jeton në një situatë ku ata janë minoritete numerike në raport me komunitetet që i rrethojnë ata. Si të këtillë, termi është i aplikueshëm për serbët e Kosovës në Graçanicë/Ulpianë njëlloj si për shqiptarët e Kosovës në veri të Mitrovicës.'

Kjo është një qasje plotësisht e përshtatshme në Kosovë. Termet 'minoritet' dhe 'të drejta të minoriteteve' janë të nevojshme kur një grup i caktuar etnik, fetar ose racor ka mungesë të pushtetit, zakonisht duke qenë një minoritet numerik në zonën ku gjendet pushteti qeveritar. Në Kosovë kjo do të thotë se çdo grup tjetër në përjashtim të shqiptarëve është minoritet. Shqiptarët janë minoritet në zonat në Kosovë që janë të dominuar nga serbët, si që janë tre komunat veriore, veriu i qytetit të Mitrovicës dhe në jug të komunës së Shterpcës.

Shifrat e popullatës në Kosovë është vështirë të verifikohen, edhe para edhe pas vitit 1999. Në RSFJ janë mbajtur regjistrime të popullatës çdo 10 vjet dhe këto regjistrime kanë përfshirë edhe kategorinë e etnicitetit. Megjithatë, regjistrimi i fundit është mbajtur në vitin 1991 por u bojkotua nga shqiptarët. Që nga viti 1999 nuk është mbajtur asnjë regjistrim tjetër. Edhe pse e tërë popullata e Kosovës pritej të regjistrohet për zgjedhje pas vitit 1999, nuk janë mbajtur shënime lidhur me etnicitetin.

Serbët

Si që theksohet më sipër, serbët kanë jetuar në Kosovë për shekuj me radhë. Kosova ka një rëndësi të veçantë për serbët për shkak të manastireve dhe legjendave lidhur me betejën e vitit 1389. Patriarku i Kishës Ortodokse Serbe është Arqipeshk i Pejës, njërës prej qyteteve më të mëdha në Kosovë dhe lokacioni i njërit prej manastireve më kryesore. Përkundër viteve të sekularizmit të propaguar nën komunizëm, identiteti serb në Kosovë është ende shumë i lidhur me Kishën Ortodokse Serbe. Serbët, megjithatë, për vite me radhë kanë qenë një minoritet numerik në Kosovë. Sipas historisë serbe, statusi i tyre minoritar filloi me ikjen e shumë serbëve pasi perandoria otomane rimposhti provincën në vitin 1690. provinca u mposht nga Serbia në vitin 1912 dhe u bënë shumë përpjekje për ta 'rikolonizuar' atë me serbë; por kjo dështoi në masë të madhe. Pasi që gjithnjë e më shumë pushtet nga Jugosllavia u kalohej autoriteteve kosovare (shumica prej tyre shqiptarë), serbët ankoreshin për diskriminim dhe disa prej tyre e lëshuan provincën. Ardhja e Millosheviqit në pushtet solli në marrjen e autonomisë së Kosovës dhe diskriminim në favor të serbëve gjatë viteve të 90-ta. Deri në vitin 1999, mendohet se ka pasur deri 300.000 serbë në Kosovë. Në disa pjesë të Kosovës serbët formonin shumicë, duke përfshirë edhe tre komunat në veri, komunën e Shtërpçës në jug dhe qytetin e Fushë Kosovës afër Prishtinës në qendër. Shumë serbë kanë jetuar në qytete të mëdha, duke formuar përafërsisht 25 për qind të popullatës në Prishtinë. Deri me fillimin e bombardimeve të NATO-s, serbët kanë qenë një grup dominues në Kosovë.

Romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit

Besohet se romët kanë ardhur në Ballkan në shekullin e 13. Ata mund të gjinden nëpër tërë Kosovën dhe shumica prej tyre janë jonomadë që herët. Disa prej tyre kanë pranuar islamin, e disa janë bërë të krishterë ortodoksë. Disa prej tyre (shumica me fe myslimane) kanë pranuar gjuhën shqipe si gjuhë të parë të tyre, disa serbo-kroatishen, ndërsa të tjerët e kanë ruajtur gjuhën rome. Sidoqoftë, si në pjesën tjetër të Evropës, të gjitha komunitetet tjera në përgjithësi i kanë trajtuar romët me një 'jorespekt social'. Së paku 1.000 romë të Kosovës u vranë gjatë Luftës së Dytë Botërore, si pjesë e Porajmos, gjenocidit ndaj romëve.

Romët megjithatë, shpeshherë kanë treguar lojalitet ndaj Jugosllavisë së pas Luftës së Dytë Botërore, të cilën gjë ata e çmonin se u jep më shumë liri se kurdoherë më parë. Numri që i identifikon ata si romë u rit prej 11.000 pas luftës deri në 43.000 në regjistrimin e vitit 1991. Shifra e fundit është sigurisht një nënlogaritje e madhe pasi që romët shpeshherë veten e kanë identifikuar zyrtarisht si shqiptarë, serbë ose turq.

Me pushimin masiv të shqiptarëve nga punësimet shtetërore në Kosovë në fillim të viteve 90-ta, disa prej pozicioneve të tyre u morën nga romët. Romët u përdorën nga autoritetet serbe gjatë pastrimit etnik në vitin 1999 për varrim të të vrarëve. Në mesin e disa shqiptarëve, kishte një imazh se romët kanë qenë 'bashkëpunëtorë' me autoritetet serbe.

Nga vitet 90-ta e këndeje, ka pasur një ndarje të qartë të romëve në tre grupe të vetëidentifikuara. Ata që flasin gjuhën shqipe si gjuhë të parë identifikonin veten si ashkalinj ose egjiptas. Egjiptasit konsideronin veten si një grup paraardhësit e të cilëve janë nga Egjipti. Të dy grupet kanë një afinitet të ngushtë me shqiptarët, por në masë të madhe kanë qenë të refuzuar nga shqiptarët. Ata që veten e tyre e konsiderojnë romë në Kosovë sot, megjithatë, në përgjithësi flasin ose gjuhën rome

ose serbe si gjuhë të parë. Pas disa mosmarrëveshjeve, e drejta në vetëidentifikim është pranuar dhe të tre grupet njihen nga UNMIK-u, bile dhe në raste të përfaqësimit sipas sistemit elektoral. Nganjëherë termi RAE përdoret për referim të të tre grupeve bashkë. Të tria grupet, mund të thuhet, se janë në pozitën më të keqe në Kosovë, me arsimim më të keq, nivel më të lartë të diskriminimit në punë dhe gati me siguri shkallë më të lartë të papunësisë. Brenda tre komuniteteve, romët janë në pozitën më të keqe.

Boshnjakët

Nën perandorinë otomane një numër i madh i folësve të gjuhëve sllave (kryesisht gjuhën e njohur si serbo-kroate) pranuan islam. Ata formonin shumicën e republikës së Bosnjë dhe Hercegovinës, dhe rajonit të Sanxhakut në Serbi dhe Mal të Zi menjëherë në veri të Kosovës. Grupi është pranuar si identifikim nacional nga Jugosllavia në vitin 1961, me një kategori regjistruese të 'myslimanëve sipas kuptimit etnik'. Gjatë luftës në Bosnjë në vitet e 90-ta, për këtë grup u adoptua termi 'boshnjak', ndërsa gjuha boshnjake u promovua si e ndryshme nga serbja dhe kroatja.

Termi 'boshnjak' gjithashtu pas vitit 1999 u pranua masovikisht edhe për myslimanët në Kosovë, gjuha e parë e të cilëve ishte gjuha boshnjake. Termi boshnjak është bërë termi i pranueshëm edhe për ata që përpara referoheshin si 'myslimanë sllav' dhe nganjëherë vetëidentifikoheshin si 'torbeshë'. Ata veçanërisht janë të interesuar që të mbrojnë gjuhën e tyre boshnjake si të ndryshme nga gjuha serbe. Komuniteti është kryesisht i fesë myslimane dhe ka numëruar të paktën 35.000 persona në vitin 1999. Vetë boshnjakët thonë se komuniteti i tyre në Kosovë ka numëruar të paktën 100.000 në vitin 1999 dhe është përafërsisht 57.000 sot.

Goranët

Komuniteti goran të vendosur në rajonin malor të Gorës në jug-perëndim, që është sigurisht rajoni më i largët i Kosovës, janë gjithashtu myslimanë dhe sllavë, por janë të ndryshëm nga boshnjakët. Gora numëronte përafërsisht 12.000 persona në vitin 1999, ndërsa komunitetet më të vogla janë të vendosura në qytetet më të mëdha të Kosovës. Numri i tyre mendohet të jenë 6.000 sot.

Kroatët

Ekzistojnë dy komunitete të vogla të kroatëve në Kosovë, Janjevë (afër Prishtinës) dhe Letnica (në jug). Identifikimi fetar si katolik ka qenë shumë i rëndësishëm për identitetin kroat dhe Letnica është një destinim për pelegrinazh.

Turqit

Nga viti 1450 deri në vitin 1912, Kosova qeverisej nga perandoria otomane dhe gjuha e qeverisë ishte turqishtja. Turqishtja u caktua si njëra prej gjuhëve zyrtare në Kosovë në Kushtetutën e vitit 1974.

Deri në vitin 1999, popullata e personave që identifikohen si turq është reduktuar në shifra që rrotullohen prej 12.000 deri 50.000. Shumica janë të vendosur në rajonin e Prizrenit, ndërsa komunitete tjera më të vogla janë vendosur në vende tjera. Shumë turq kanë shuar në Turqi për të ikur nga lufta ose papunësia. Çështja kritike për turqit ka qenë njohja dhe mbrojtja e gjuhës së tyre.

Shqiptarët

Shqiptarët për një periudhë të konsiderueshme kanë qenë grup shumicë në Kosovë. Megjithatë, ata kanë qenë minoritet në Serbi si shtet në tërësi, dhe kanë vuajtur nga politikat që kanë pasur për qëllim reduktimin e numrit të tyre dhe influencës së tyre në Kosovë, duke arritur kulmin me largimin e pushtetit të tyre politik në vitin 1989, humbjen e punës dhe të drejtave gjuhësore, dhe pastrimin etnik në mars-qershor të vitit 1999. Me largimin e autoriteteve në RFJ-së në qershor të vitit 1999, shqiptarët sërish vijnë në pozitë pushteti në Kosovë. Megjithatë, ata kanë qenë ose janë bërë minoritet në zonat e dominuara me serb, përfshirë këtu tre komunat veriore, veriun e qytetit të Mitrovicës dhe komunën e Shtërpcës në jug. Në zonat ku shqiptarët janë minoritet, ata shpeshherë kanë përjetuar probleme të ngjashme me ata të minoriteteve në vende të tjera të Kosovës (përfshi dëbim nga shtëpitë e tyre, diskriminim dhe restriksione në përdorimin e gjuhës së tyre).

Çerkezët, çifutët, vllahët

Në vitet e 1860-ta, perandoria otomane vendosi me mijëra çerkezë refugjatë (nga Kaukazi) në Kosovë dhe pjesë të tjera të Ballkanit. Shumë prej tyre ikën nga Kosova me përzënien e otomanëve në vitin 1912. Deri në vitin 1999 disa qindra sish mbetën në dy fshatra të Kosovës dhe janë mjaftë të qetë.

Komuniteti çifut i Kosovës ka numëruar disa qindra sish në vitin 1941. Gjysma e tyre janë transportuar në vendet e vdekjes në Holokaust ndërsa pjesa më e madhe e atyre që ngelën shkuan në Izrael pas viti 1945. Popullata çifute sot është shumë e vogël.

Një grup i zhdukur në Kosovë janë vllahët, një popull ortodoks që në të kaluarën ka numëruar me mijëra. Megjithatë, pas pushtimit serb të vitit 1912 ata janë asimiluar plotësisht në serb dhe askush sot në Kosovë nuk identifikohet si vllah.

Ekspertët e minoriteteve? Qeverisësit e Kosovës dhe njohuritë e tyre për të drejtat e minoriteteve

Për të kuptuar çfarë është bërë dhe çfarë jo në Kosovë, është e nevojshme të kuptohet struktura e komplikuar e qeverisjes e cila doli që nga viti 1999 e këndeje. Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të KB-së 1244 e vitit 1999 bëri të qartë se Kosova mbetet pjesë e Republikës Federale të Jugosllavisë. Në praktikë, Kosova është qeverisur plotësisht e ndarë nga RFJ (që në vitin 2003 u bë unioni i shteteve Serbi dhe Mali i Zi, dhe momentalisht është duke u ndarë në dy republika të ndryshme duke pasuar referendumin). Autoriteti kryesor qeverisës në Kosovë është Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë, i themeluar si një 'prezencë ndërkombëtare civile' sipas rezolutës 1244. Rezoluta 1244 këtij misioni i jep përgjegjësi për:

'a. Promovimin e themelimit, pas një vendosje finale, të autonomisë substanciale dhe vetëqeverisje në Kosovë, duke pasur plotësisht parasysh aneksin 2 të Marrëveshjes së Rambujesë (S/1999/648);

b. Performim të funksioneve bazike civile administrative aty ku është e nevojshme dhe për sa kohë është e nevojshme ...

j. Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut

k. Sigurim i kthimit të sigurt dhe të papenguar të të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre në Kosovë.'

Kjo administratë e përkohshme është duke zgjatur për afër shtatë vite, supozimi më i gjatë i qeverisë në historinë e KB-së. UNMIK-u ka zhvilluar një strukturë mjaftë komplekse, të përbërë prej katër 'shtyllave'. Fillimisht këto shtylla përbëheshin prej: UNMIK-u, përgjegjës për administrim/qeverisje në shumicën e zonave; UNHCR-ja, përgjegjëse për rikonstruim, OSBE-ja, përgjegjëse për ndërtim institucional; dhe misioni i UE-së përgjegjës për zhvillim ekonomik. UNHCR-ja e lëshoi strukturën e shtyllës së majtë në vitin 2000, dhe u zëvendësua nga një shtyllë e dytë e UNMIK-ut përgjegjëse për policinë dhe drejtësinë. Trupa të tjerë të KB-së, si Zyra e Komisarariatit të Lartë për të Drejtat të Njeriut (OHCHR), gjithashtu kanë pasur zyra në Kosovë, njëjloj si edhe Këshilli i Evropës, por këto nuk ishin pjesë e UNMIK-ut. UNMIK është udhëhequr nga një Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP); të tillë ka pasur një numër të çuditshëm që nga viti 1999 (përveç ushtruesit të parë të detyrës PSSP të gjithë kanë qenë meshkuj nga Evropa).

'Prezenca ndërkombëtare e sigurisë' e vendosur me Rezolutën 1244 është e quajtur KFOR. Është një forcë multinacionale dhe ka të paktën 30 shtete pjesëmarrëse, shumica prej tyre anëtare të NATO-s, por gjithashtu përfshin edhe vende si India, Rusia dhe Suedia. KFOR u themelua si një trup i veçantë prej UNMIK-ut dhe, edhe pse domosdoshmëritë e punës kërkojnë bashkëpunim me UNMIK-un, KFOR-i mbetet plotësisht autonom, jo i kontrolluar nga autoriteti civil në Kosovë (për dallim nga situata e administratës së KB në Timorin Lindor). Për të qenë situata edhe më konfuze, përderisa KFOR në teori ka një strukturë të unifikuar komanduese, të udhëhequr nga një Komandues (COMKFOR), në praktikë njësitë nacionale brenda KFOR-it shpesh kanë vepruar sipas prioriteteve të tyre. Në veçanti, pesë brigadat e ndryshme initiale në Kosovë, secila prej tyre e udhëhequr nga një vend i ndryshëm (Franca, Gjermania, Italia, MB dhe SHBA) udhëhiqte një rajon të ndryshëm dhe kishin politika mjaft të ndryshme lidhur me sigurinë dhe minoritetet. Mandati i KFOR-it sipas Rezolutës 1244, përfshin këto përgjegjësi:

'c. Vendosjen e një mjedisi të sigurt në të cilin refugjatët dhe personat e zhvendosur mund të kthehen në shtëpi të sigurt, mjedis në të cilin mund të operojë prezenca ndërkombëtar civile, mund të themelohet një administratë tranzicionale, dhe mund të ofrohet një ndihmë humanitare;

d. Sigurimi i sigurisë dhe rendit publik derisa përgjegjësinë për këtë detyrë mund ta merr prezenca ndërkombëtare civile ... '

Përpjekjet për të pasur një involvim të kosovarëve në qeveri kanë shtuar edhe më tepër kompleksitetin e strukturave qeveritare. Fillimisht, dështimi i UNMIK-ut për të vendosur autoritet la pushtet efektiv në pjesën më të madhe të Kosovës në duart e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në zonat serbe situata ishte një përzierje e autoritetit të Beogradit ('strukturat paralele' në këto fushën e sistemit të drejtësisë dhe arsim) dhe pushtet ditor në fushat si ajo e sigurisë me grupe joformale serbe. Në fund të vitit 1999 u vendos një strukturë për të formalizuar këto marrëdhënie. E quajtur si Struktura e Përbashkët e Përkohshme Administrative (SPPA), ajo krijoi një Këshill të Përkohshëm Administrativ (KPA) të përbërë prej tre shqiptarëve dhe më vonë edhe një serb, dhe vendosi një sistem i cili përbëhej nga ministrinë të cilat bashkëudhëhiqeshin nga një zyrtar ndërkombëtar i UNMIK-ut dhe një kosovar. Në vitin 2000 u organizuan zgjedhjet për autoritete komunale dhe pushteti iu kalua këtyre autoriteteve lidhur me një fushë të gjerë të çështjeve lokale. Në vitin 2001 u shpall Korniza Kushtetuese nga ana e PPSP, e cila është në fakt, një Kushtetutë e Përkohshme për Kosovën. Kjo krijoi një sistem të njohur si 'Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes' (IPV). Pas zgjedhjeve për Parlamentin e Kosovës në vitin 2001, u zgjodh një qeveri e gjerë e Kosovës që përbëhej prej Kryetarit, Kryeministrit dhe ministrave kosovar. Pjesa më e madhe e autoriteteve të përditshme të UNMIK-ut veç është kaluar në autoritete kosovare. Në tetor të vitit 2005, Këshilli i Sigurimit vendosi të lancojë procesin për zgjidhjen e statusit të ardhshëm të Kosovës.

Megjithatë UNMIK-u dhe PPSP edhe në teori edhe në praktikë kanë ngelur vendimmarrësit më të rëndësishëm të Kosovës. Autoriteti i fundit qëndron tek ata, ndërsa një pjesë e pushtetit mbahet nga ata edhe pas krijimit të IPSP (më mirë të njohur si policia dhe drejtësia). PPSP, sipas Kornizës Kushtetuese, e mban të drejtën për të intervenuar në qeveri në cilëndo kohë dhe nga ai kërkohet të veprojë kështu për të mbrojtur komunitetet.

KFOR-i, edhe pse është reduktuar shumë në numër, ka mbajtur shumë pushtet gjatë këtyre shtatë viteve. Në asnjë kohë KFOR-i nuk ka deklaruar misionin e tij si të atillë që të sigurojë siguri dhe rend publik dhe të dorëzojë plotësisht përgjegjësitë. Prandaj shumë pushtet lidhur me çështje që afektojnë minoritetet ka mbetur në KFOR.

Prandaj, Kosova është efektivisht një protektorat për shtatë vite me radhë. Duke i pasur parasysh organizatat e involvuara, dikush mund të kishte pritur një kuptim të thellë të të drejtave të minoriteteve dhe implementimin e tyre. KB-të kanë qenë në qendër të zhvillimit të të drejtave ndërkombëtare të minoriteteve. Traktatet e saj të mëdha për të drejtat e njeriut janë direkt relevante për të drejtat e minoriteteve. Në vitin 1992, Asambleja e Përgjithshme miratoi Deklaratën mbi të Drejtat e Personave që u Takojnë Minoriteteve Kombëtare ose Etnike, Fetare ose Gjuhësore, deklarata kjo e cila vendosi të drejtat përgjithësisht të pranuar për të gjitha minoritetet. Neni i saj final nr 9 thekson se:

'Agjencitë e specializuara dhe organizatat tjera të sistemit të Kombeve të Bashkuara do të kontribuojnë për realizimin e plotë të të drejtave dhe parimeve të caktuara me Deklaratën aktuale, brenda fushave të tyre respektive të kompetencës.'

KB-të kanë një Grup të specializuar për Minoritetet, i cili takohet në Gjenevë dhe ka një staf ndihmës që përbëhet prej ekspertëve të specializuar për çështje të minoriteteve brenda Zyrës së KB-së së Komisarariatit të Lartë për të Drejta të Njeriut. Pasi u themelua UNMIK-u, KB-të kanë zhvilluar më tej ekspertizën e tyre lidhur me minoritetet me krijimin e Këshilltarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Parandalimin e Gjenocidit dhe një Ekspert të Pavarur për Çështje të Minoriteteve. OSBE-ja, e cila formon një pjesë të UNMIK-ut, ka pasur, nëse jo diçka tjetër, një njohuri shumë të madhe të të drejtave të minoriteteve, dhe veçanërisht lidhur me atë se si duhet ato të përdoren gjatë zgjidhjes dhe parandalimit të konflikteve. Kjo është kështu që nga krijimi i Zyrës së Komisionerit të Lartë për Minoritetet Kombëtare në vitin 1992. E vendosur në Hagë, kjo zyrë është themeluar si një mekanizëm për parandalimin e konflikteve, i dizajnuar për të identifikuar çështjet e minoriteteve të cilat do të kishin mundur të shkaktojnë konflikte dhe për të rekomanduar zgjidhje, në pjesën më të madhe përmes 'diplomacisë së qetë'. Në vitet 1990-të kjo zyrë ka punuar shumë në Evropën Qendrore dhe në shtetet e Baltikut, por gjithashtu ka zhvilluar dhe publikuar udhëzues për atë se si duhet të adresohen çështje kritike të minoriteteve, përfshirë këtu participimin publik, arsimin, të drejtat gjuhësore, sistemin elektoral dhe mediumet.

Në fakt ajo që ka ndodhur në Kosovë ka qenë e kundërta e asaj që është pritur. Përkrah njohurive të shkëlqyeshme që kanë KB-të dhe OSBE-ja për të drejtat e minoriteteve, të njëjtat nuk janë mbrojtur në Kosovë. Pastrimi etnik ndodhi në vitin 1999 dhe në vitin 2004 dhe trendi i përgjithshëm ka qenë kah një segregacion i përgjithshëm, dhe jo një integrim. Edhe pse janë mbledhur shumë informata lidhur me situatën e minoriteteve, politikat lidhur me minoritetet duket se kanë qenë shumë të rastësishme dhe konfuze, dhe shumë rrallë të bazuara në të drejta.

Për të shqyrtuar çfarë ka ndodhur, në vazhdim do të përshkruhen strukturat e ndryshme që u themeluan për të adresuar të drejtat e minoriteteve, dhe çfarë ato në fakt arritën.

Një tepri e zgjidhjeve: themelimi i strukturave për t'u marrë me minoritetet

Gjatë viteve trupa të ndryshme qeveritare kanë themeluar një varietete të strukturave institucionale për të adresuar çështjet e minoriteteve. Çështjet e minoriteteve janë njohur si një prioritet madhor për UNMIK-un që në fillim dhe ushtruesi i parë i detyrës së PSSP-së e bëri këtë të qartë në një fjalim në korrik të vitit 1999. Një rezultat imediat ishte themelimi nga ana e UNHCR-së dhe OSBE-së (atëherë të dyja pjesë të UNMIK-ut) i një ndër-agjencioni Ad Hoc Task Force për Minoritetet. Ky trup, fillimisht i kryesuar nga UNHCR, dhe pastaj nga OSBE-ja, u mundua të identifikojë problemet kyçe me të cilat ballafaqohen minoritetet në Kosovë dhe të dalë me zgjidhje dhe rekomandime të politikave. Është udhëhequr në masë të madhe nga ana e këtyre dy organizatave, por gjithashtu ka involvuar edhe personel të UNMIK-ut dhe KFOR-it – dhe shumë rrallë ka pasur participim të minoriteteve. Në fillim Task Forca takohej në javë, u përgjigjej çështjeve imediate, veçanërisht shikuar nga perspektiva e stafit të OSBE-së dhe UNCHR-së, dhe ka pasur pak ndikim nga ana e politikave të KFOR-it. Atëherë filloi të adresojë probleme sistematike. Megjithatë, edhe OSBE-ja edhe UNCHR-ja kanë ndier se Task Forca nuk është duke u dëgjuar dhe vendosi që të njëjtin ta shkatërrojë në vitin 2001, duke argumentuar se ajo që kërkohej në këtë moment ishte një trup i udhëhequr nga UNMIK-u që do të ishte në mundësi të zhvillojë dhe implementojë politikat e UNMIK-ut.

Ndikimi i Task Forces mund të shihet dukshëm në dhjetë vlerësimet e përbashkëta publike të OSBE/UNHCR lidhur me situatën e minoriteteve në Kosovë të publikuar gjatë viteve 1999 dhe 2003. Këto janë përshkrime të detajizuara lidhur me atë se çfarë i ka ndodhur çdo grupi minoritar gjatë një periudhe kritike. Është e mundshme që gjatë kësaj periudhe Kosova ka pasur një vlerësim më të thellë të situatës së minoriteteve se në çfarëdo vend tjetër. Kjo gjithashtu çoi kah ajo që çështjet minoritare të jenë një prioritet i lartë edhe për UNHCR-në edhe për OSBE-në.

UNMIK-u gjithnjë e më shumë vendosi strukturat e veta të fokusuara në minoritetet. Në shtator të vitit 1999 UNMIK-u krijoi Zyrtarët e Çështjeve Civile Minoritare, e cila në vitin 2000 u riemërua si Zyrtarë të Komuniteteve Lokale. Në fillim të administratës, UNMIK-u kishte një këshilltar të lartë të të drejtave të njeriut, i cili punoi ngushtë me OSBE-në. Megjithatë, pasi që ai u largua, askush tjetër nuk e zuri vendin e tij, pjesërisht për shkak të mosmarrëveshjeve në mes Prishtinës, OHCHR dhe Departamentit të KB-së për Operacione Paqeruajtëse (DOPR) lidhur me atë se kush duhet ta bëjë këtë emërim dhe çfarë kualifikime të të drejtave të njeriut kërkohet që ai person të ketë. Gjatë një periudhe të përkohshme, UNMIK-u zhvilloi një zyrë e cila u fokusua në çështje të të drejtave të njeriut në përgjithësi, dhe veçanërisht lidhur me kthimin. Në fund të vitit 2001 kjo u formalizua në një “Zyrë për Kthimin dhe Komunitetet”, e cila nga UNHCR-ja e ndërmori koordinimin e politikave lidhur me kthimin, dhe është marrë me çështje tjera më të përgjithshme që afektojnë minoritetet. Në dhjetor të vitit 2001, UNMIK-u themeloi një Bord Këshillëdhënës për Komunitetet në mënyrë që ai të sigurojë këshilla për politikën lidhur me çështjet e minoriteteve. Kjo ndihmoi për zhvillimin e politikave lidhur me punësimin dhe ta shtyjë përpara miratimin e ligjit antidiskriminim.

Themelimi i institucioneve kosovare përfshiu edhe mekanizma të organizuara për adresimin e çështjeve minoritare. Nga autoritetet komunale të themeluara në vitin 2000, sipas ligjit u kërkua që të themelojnë Komitete të Komuniteteve në çdo komunë. Korniza Kushtetuese kërkoi që Parlamenti i Kosovës të themelojë një Komitet për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Institucionet e para të Përkohshme të Vetëqeverisjes përfshinë Zyrën Këshillëdhënëse të Kryeministrit për Çështje të Komuniteteve. Për një periudhë të gjatë, qasjet drejt çështjeve të minoriteteve në departamentet qeveritare ngelën kaotike. Në kohën kur ministritë ende kontrolloheshin nga UNMIK-u, Departamenti i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ishte i pari që krijoi një pozitë të këshilltarit të minoriteteve. Në vitin 2001, OSBE-ja dhe UNHCR-ja vërejtën një përmirësim në përpjekjet për t’u marrë me çështjet e minoriteteve në Departamentin për Shërbime Publike. Nga fundi i vitit 2001, UNMIK-u krijoi një Sektor për Integrim Gjyqësor për të përmirësuar aksesin e minoriteteve në sistemin gjyqësor. Por për vite me radhë këto ishin vetëm disa shembuj të kufizuar.

Një dështim tjetër i dukshëm për integrimin e politikave ishte ai lidhur me koordinimin e politikave gjinore dhe minoritare. Çështjet gjinore nuk duket të kenë qenë të koordinuara sistematikisht në strukturat institucionale për të adresuar çështjet minoritare. Në vend të kësaj, u themeluan struktura të ndara për çështje gjinore, me pak përpjekje për të vënë kujdes në diskriminimin e shumëfishtë. Në çështjen e kthimit të minoriteteve, janë bërë përpjekje për koordinimin e politikave nga viti 2000 e këndej. Komiteti i Përbashkët për Kthimin e Serbëve të Kosovës (KPK) u themelua dhe u kryesua nga UNHCR ndërsa në të mirrte pjesë edhe UNMIK-u, OSBE-ja, KFOR-i dhe liderët serbë. Vetë emërtimi tregon se ky komitet u dizajnuar si një trup politik koordinues, duke u fokusuar vetëm në grupet etnike. Megjithatë, ai zhvilloi një garniturë të përgjithshme të parimeve dhe në vitin 2001

duke ndërruar fokusin në kthimin e të gjithë të zhvendosurve, u bë një Task Forcë për Kthim dhe Riintegrim duke u fokusuar në të gjitha komunitetet. U themeluan grupet punuese rajonale dhe komunale për kthim në mënyrë që të involvojnë edhe autoritete lokale. Në vitin 2002, UNMIK-u në formë të Zyrës së tij për Kthim dhe Komunitetet e ndërmori përgjegjësinë për këtë punë. PSSP gjithashtu emëroi një serb të Kosovës si Këshilltar për Kthim në vitin 2001. Në janar të vitit 2005 IPVQ emëruan një serb të Kosovës si Ministër për Kthim dhe Komunitete.

Pastrimi etnik, të zhvendosurit dhe kthimi

Në zemër të mbrojtjes së të drejtave të minoriteteve në Kosovë është zhvendosja që ndodhi në vitin 1999 dhe 2004 dhe dështimi për ta anuluar këtë. Prandaj është e domosdoshme që të shqyrtohet kjo në më shumë detaje.

Është llogaritur se në periudhën mars - qershor të vitit 1999, mbi 800.000 shqiptarë u dëbuan nga Kosova. Të paktën 100.000 serbë gjithashtu e lëshuan Kosovën, duke ikur nga bombardimet. Ky ishte shkaku përse një komponentë kyçe e mandatit dhe detyrave të UNMIK-ut dhe KFOR-it ishte të sigurojë kthim të të zhvendosurve. Për shqiptarët e zhvendosur gjatë pranverës, kthimi u bë shpejt – megjithëse, autoritetet ndërkombëtare në fillim u munduan që të vendosin një kthim të kontrolluar, por shumë shpejt e lëshuan këtë mendim pasi që shumica e të zhvendosurve thjeshtë u kthyen kur panë se pozita ishte e sigurt. Megjithatë, me ardhjen e UNMIK-ut dhe KFOR-it u bë edhe një eksod masiv dhe zhvendosje brenda Kosovës, zhvendosje kjo e minoriteteve të Kosovë – veçanërisht serbëve, romëve dhe në zona të veçanta shqiptarëve. Deri në tetor të vitit 1999 Kryqi i Kuq Jugosllav theksoi se kishte 234.000 serbë dhe romë përkohësisht të zhvendosur (PZHP) nga Kosova në Serbi dhe Mal të Zi.

Arsyet për këtë kanë qenë të shumta. Me largimin e forcave të armatosura dhe administratës së RFJ-së shumë serbë ikën menjëherë duke pasur frikë nga ajo që mund të ndodhte më pas. Megjithatë, arsyeja kryesore për ikjen e vitit 1999 ishte kampanja sistematike e frikësimit kundër minoriteteve, e cila qartazi kishte për qëllim që t'i detyrojë ata që të lëshonin Kosovën si tërësi ose të lëshonin pjesë të caktuara të saj. Vala e parë e këtij frikësimi është dokumentuar në mënyrë gjithëpërfshirëse nga OSBE-ja dhe organizata të tjera. Ky frikësim ka përfshirë frikësim verbal dhe fizik, dhe djegien dhe okupimin e shtëpive të minoriteteve. Vrasjes së 14 fermerëve serb gjatë korrjeve në Lipjan (Kosova qendrore) në 23 korrik 1999 iu dha mjaft publicitet në atë kohë. OSBE-ja ka llogaritur se numri i vrasjeve duhet të ketë qenë të paktën 50 në javë në verën e vitit 1999 dhe tre vrasje në javë në tetor të po të njëjtit vit.

Rezultati i kësaj ishte se Kosova u bë një provincë rreptësisht e ndarë sipas etnicitetit. Shqiptarët ikën nga zonat e dominuara nga serbët, kryesisht të vendosur në veri të qytetit të Mitrovicës. Serbët ikën nga shtëpitë e tyre në Kosovë, duke pasur si pasojë faktin se jashtë veriut, ata u kufizuan në enklava. Enklava më e madhe prej këtyre ishte ajo në Shtërpçë në jug, ndërsa enklava të tjera serbe përfshinë qytetin e Fushe Kosovës (ku më parë serbët kanë qenë shumicë) dhe qendrën e qytetit të Rahovecit (ku serbët kanë jetuar në të ashtuquajtura geto). Në komunën e Prishtinës, numri prej 50.000 serbëve që jetonin atje në qershor të vitit 1999, është reduktuar në 600 deri kah fundi i tetorit të vitit 1999. Dy vrasje në rrugët e Prishtinës në vitin 1999, të cilave iu dha shumë publicitet, rrënoi çdo besim të mbetur të cilin serbët kanë mund të kenë në aftësinë e administratës ndërkombëtare për t'i mbrojtur. Në fillim ndodhi vrasja e një anëtarit të stafit të UNMIK-ut të ardhur nga Bullgaria në tetor, siç thuhej atëherë për shkak se vrasësit e tij besonin se ai fliste në serbisht. Atëherë, në Ditën e

Flamurit të Shqipërisë, një familje serbe nga Prishtina u tërhoq nga vetura nga një turmë që i sulmoi ata, njëri u godit për vdekje ndërsa vetura u dogj. Përkundër qindra dëshmitarëve të vrasjes vetëm një person u arrestua, i cili pastaj i iku paraburgimit të KFOR-it.

Sulmet dhe frikësimet në të njëjtën masë targetonin edhe romët, të cilët publikisht u akuzuan se kanë qenë ‘bashkëpunëtorë’ me regjimin e Millosheviqit. Romët ikën nga shtëpitë e tyre në Kosovë, dhe dukshëm edhe nga mëhallët rome në jug të qytetit të Mitrovicës, i cili u dogj. Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve e ka përshkruar këtë pastrim etnik si ‘katastrofën e vetme më të madhe kundër komunitetit rom që nga Lufta II Botërore’.

Boshnjakët, kroatët dhe goranët gjithashtu u ndjenë të jenë vënë në një presion të ashpër gjatë kësaj periudhe, me masa të ngjashme të sulmeve dhe okupime të shtëpive. Komuniteti kroat në Letnicë thuhej që është duke vuajtur ‘dëshpërim dhe heqje dorë nga to’ për shkak të ngacmimeve dhe dështimit për të siguruar mbrojtje nga UNMIK-u dhe KFOR-i, prandaj shumica ikën për në Kroaci.

Minoritetet që i lanë shtëpitë e tyre u bënë persona të zhvendosur për përherë. Shqiptarët dhe disa serbë shkuan në shtëpi të tjera brenda Kosovës, por shumica e serbëve dhe kroatëve ikën në Kroaci dhe Serbi. Romët, duke mos pasur ku tjetër të shkojnë, shumë shpesh mbaronin në kampe të zhvendosurve, më e njohura në Plementin në Kosovën Qendrore, ku ata vuanin për shkak të kushteve shumë tepër të këqija dhe vendit të ngushtë, ndërsa disa kampe u tha të jenë të pabanueshme për shkak të kontaminimit.

Minoritetet që mbetën jetonin në një situatë të frikës ekstreme dhe dhunës. Ata u ndjenë të paaftë që të lëvizin lirshëm, për shkak të frikës nga sulmet, dhe shpesh mbështeteshin në eskortat e armatosura të KFOR-it për ta bërë edhe lëvizjen më të vogël. Disa minoritete, si që janë disa qindra serbë të mbetur në Prishtinë, u gjetën të kufizuar në vetëm një ndërtesë banesore, të rrethuar nga forcat e armatosura. Minoritetet u ndjenë plotë me frikë lidhur me të folurit e gjuhës së tyre publikisht nga frika se mos sulmoheshin. Ata gjithashtu u ndjenë sistematikisht të përjashtuar nga shërbimet publike për shkak se kishin mungesë të lirisë së lëvizjes dhe diskriminimit që ishte prezent në vetë shërbimet.

Evidencë e papërballueshme është se frikësimi ishte sistematik dhe ishte si qëllim direkt detyrimin e minoriteteve që të ikin dhe prandaj paraqet një pastrim etnik. Për të kuptuar kush e organizoi këtë dhe përse u lejua që të ndodh është e domosdoshme që të kuptohet kush ka pasur pushtetin në Kosovë në vitin 1999. KFOR hyri në Kosovë shumë shpejt, pasi që kishte një armatë në kufi që ishte e gatshme për invazion tokësor. Megjithatë, UNMIK-u nuk kishte staf të administratës apo as edhe polici në vend deri më vitin 2000 dhe mezi filloi të plotësohet gjatë vitit 1999. zbrazëtira që rezultoi në autoritetin civil dhe policor u plotësua nga ata me armë që ishin të gatshëm që të përdorin frikësim për të imponuar autoritetin e tyre, shumica anëtarë të mëparshëm të UÇK-së. Ata themeluan ‘autoritete nën hije’ nëpër pjesët e banuara me shumicë shqiptare, duke përfshirë edhe persona që pretendonin për pushtet policor. Në pjesën veriore serbe, një grup i njohur si ‘rojtaret e urës’ dukeshin se supozojnë autoritet, dhe ishte gati se e sigurt se kishin mbështetje nga Beogradi. OSBE-ja qartësisht i lidhte të dy grupet me ngacmimet dhe nxjerrjen e minoriteteve në zonat e tyre, si që atëherë u bë e ditur nga ish PSSP. OSBE-ja theksoi se ‘evidenca në një pjesë paraqet një targetim të kujdesshëm të viktimave dhe një qëllim të bazuar të dëbimit’ dhe ‘Një tipar konsistent raportues është supozuar si prezencë dhe kontroll i UÇK-së’.

Ajo që është goditëse për vitin 1999, dhe i ka përcaktuar ngjarjet në Kosovë që atëherë, është se as UNMIK-u dhe as KFOR-i kanë qenë të vullnetit dhe as të aftë që të ndërmarrin aksione efektive. UNMIK-u ka pasur mungesë të stafit, veçanërisht lidhur me policinë. KFOR-i, një armatë ndërkombëtare, është fokusuar në mbrojtjen e Kosovës nga forcat jugosllave, dhe nuk është marrë me pastrimin etnik sistematik. Përgjigja e vetme e KFOR-it në vitin 1999 është bërë për të mbrojtur disa minoritete të ngelura përmes pikave të kontrollit dhe eskortave statike – dhe kjo ndodhi vetëm në kohën kur KFOR-i ishte në fuqinë më të madhe të vet.

Nuk është bërë ndonjë përpjekje e madhe për të demonstruar publikisht intolerancën e re të qeverisësve ndërkombëtar lidhur me pastrimin etnik, veçanërisht përmes identifikimit dhe arrestimit të personave të përgjegjshëm. Në vend të kësaj, duke lejuar që frikësimi të vazhdojë, UNMIK-u dhe KFOR-i në mënyrë efektive kanë treguar se ata kanë toleruar pastrimin etnik dhe ndarjen e Kosovës. Përveç asaj që kanë qenë të fajësuar për pastrim etnik nga OSBE-ja, liderët e UÇK-së dhe, më vonë, anëtarët e ‘rojtareve serb të urës’, u emëruan në pushtet. Shumica nga ‘autoritetet nën hije’ që ishin të lidhur me frikësimin e minoriteteve u njohën nga ana e UNMIK-ut si autoritete efektive të komunave, të paktën deri në zgjedhjet e para në fund të vitit 2000. UÇK-së iu garantua një numër fiks i rekrutëve të parë në Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK). Më e njohura, edhe pse UÇK-ja zyrtarisht u shpërnda në shtator të vitit 1999, u krijua Trupat Mbrojtës i Kosovës (TMK). Edhe pse zyrtarisht një forcë ‘për mbrojtje civile’, ky trup gjithnjë është lejuar të portretizojë veten si pasardhës i UÇK-së dhe si një armatë (dhe vërtetë në fillim ishte i monitoruar nga KFOR-i), dhe, veçanërisht në vitin 1999, ky trup ndërmori veprimtari policore të stilit të vet nëpër tërë Kosovën. Edhe pse Rregullorja (1998/8) që e themeloi TMK-në theksonte se 10% e anëtarëve të saj duhet të jenë nga minoritetet, emblema e saj ishte e ngjashme me UÇK-në (në ngjyra shqiptare) dhe ishte e lidhur për një periudhë të konsiderueshme me sulme ndaj minoriteteve dhe shqiptarëve të tjerë, dhe ishin kundër përdorimit të gjuhës serbe.

UNMIK-u dhe KFOR-i duket të kenë qenë të tejngarkuar nga pastrimi etnik në vitin 1999 dhe nuk kanë ditur se si ta kthejnë atë mbrapsht. Edhe përkundër evidencës se pastrimi etnik duhet të kthehet mbrapsht shpejt nëse kjo gjë veç duhet të bëhet, nuk u bë ndonjë përpjekje e madhe dhe sistematike për të thyer barrierat, për të kthyer izolimin e minoriteteve dhe për të lejuar ata që të kthehen. Mesazhi që erdh nga KFOR-i dhe UNMIK-u gjithmonë ishte se nuk ishte ‘koha e duhur’ për kthim, dhe ndarjet, veçanërisht në qytetin e Mitrovicës, e vështirësonin këtë në linja të ngurta të hartës. Kjo duket të ketë ndodhur për shkak të mosvullnetit për t’i marrë ato liderë shqiptarë dhe serbë që kanë promovuar pastrim etnik dhe segregacion të Kosovës.

Në vitet që pasuan, minoritetet vazhduan të lëshonin Kosovën. Autoritetet e gjetën të vështirë që t’i sigurojnë minoritetet me tre ‘fjalët’ – siguri, hapësirë (shtëpi) dhe qëndrueshmëri – që janë kryesore jo vetëm për kthimin por poashtu edhe për sigurimin se komunitete të izoluar mund të qëndrojnë në Kosovë. Minoritetet vazhduan të ndjehen të pasigurt në mënyrë kronike. Edhe pse u ul numri i sulmeve ndaj minoriteteve nga shkalla e lartë e vitit 1999, vetëm një pakicë kishin mundësi që të udhëtojnë lirshëm. Në çdo moment mund të fillonin sulme të reja. Përpjekjet e bëra nga UNMIK-u për të pretenduar autoritetin e vet në Kosovën veriore, përfshirë edhe qytetin e Mitrovicës, gjithnjë njëlloj takonin në dhunë publike dhe sulme. Një sulm i dukshëm dhe publik mbi minoritetet ishte bombardimi në vitin 2001 i shërbimit të “Nish ekspres” që lidh serbët në komunitete të izoluar në Kosovën qendrore me Serbinë. Lidhur me çështjen kritike të besimit në aftësinë e autoriteteve për t’i mbrojtur ata, minoritetet asnjëherë nuk kanë qenë në mundësi që të ndjehen të sigurt.

Si që do të pasqyrohet më poshtë, në zonën kritike të shtëpive – që ripretendonin shtëpitë e okupuara, rindërtimin e shtëpive të prishura dhe mbrojtjen e minoriteteve nga shitja e detyrueshme e shtëpive – autoritetet ndërkombëtare kanë bërë shumë pak. Ngacmimi që çonte kah shitja e shtëpive rezultoi me atë që shumë minoritete ikën nga Kosova, si që ishte rasti me romët në Ferizaj. Dhe fakti i jetesës në kushte të këtilla, shumë shpesh në paaftësi për të udhëtuar, e bëri jetesën e përditshme dhe të qëndrueshme të pamundshme, kështu që minoritetet u dorëzuan dhe ikën.

Lidhur me kthimin e minoriteteve të zhvendosura, është bërë shumë pak gjatë muajve të para kritike; në vend të kësaj të zhvendosurit u bënë gjithnjë e më shumë permanent. Para krijimit të KPK kah mesi i vitit 2000 nuk ka pasur koordinim ndërsa politikat implementoheshin në mënyrë të çrregullt. Për shembull, armata britanike kishte policinë e vet për kthimin e serbëve në Prishtinë, ndërsa zyra amerikane (ambasadë) u mundua që të vendosë skemën e vet për kthimin e serbëve në një fshat n veri të provincës. KPK filloi të koordinojë këtë aksion më vonë, por për një kohë të caktuar fokusoji vëmendjen e vet në kthimin e shkallës së vogël nëpër fshatra të caktuara (kryesisht në Istok) se sa në adresimin e problemeve të mëdha të Kosovës si që ishin siguria, prona dhe diskriminimi.

Një qasje e caktuar në mënyrë direkte shkelte të drejtat e minoriteteve gjatë kthimit. Parimi bazik i çdo kosovari që kishte të drejtë në kthim në shtëpitë e tyre u vendos në Rezolutën 1244 dhe prandaj nga UNMIK-u dhe KFOR-i u kërkua që të prioritzojnë këtë. Megjithatë qasja e shumicës së njësive të KFOR-it ishte që të mundohen të kontrollojnë këtë kthim dhe, në veçanti, që të thonë se kjo nuk ka mundur të kryhet para se KFOR-i të krijojë një ‘mjedis të sigurt’. Kjo nganjëherë e ka çuar KFOR-in që të implementojë politika që kanë rezultuar me kundërkthim. Një shembull i njohur ishte KFOR-i gjerman, në veriperëndim në vitin 2000-1, që shumë shpesh kanë portretizuar kthimin në atë kohë si ‘të hershëm’ dhe që do të sjellë në turbulenca. Në vend që të merret me turbulencat. KFOR-i gjerman u mundua të parandalojë kthimin, përmes vendosjes së pikave të kontrollit dhe monitorimit të personave që hyjnë në zonat serbe, për të parandaluar cilindo që ‘nuk është i autorizuar; që të hyjë në ato zona. Kjo ishte një shkelje serioze e të drejtave të të gjithë njerëzve që të përcaktojnë kur kanë shprehur dëshirën për të hyrë dhe për t’u kthyer në shtëpitë e tyre. Vetëm në kohën kur shefi i OSBE-së dhe COMKFOR-it kanë intervenuar, për shkak se kanë qenë të shqetësuar për bojkotimin e serbëve në zgjedhjet e vitit 2001, KFOR- i gjerman e relaksoi politikën e vet.

Si që është theksuar më sipër, gradualisht politikat e kthimit u bënë më të koordinuara, veçanërisht pas krijimit të Zyrës së Kthimit dhe Komunitetit. UNMIK-u dhe UNHCR-ja ka prodhuar një manual për kthim të qëndrueshëm në vitin 2003. Megjithatë, doli që numri i të kthyerve në fakt shkoi teposhtë në vitin 2002, edhe pse u rrit pak gjatë vitit 2003.

Mars 2004

Në fillim të vitit 2004 UNMIK-u pretendonte për shumë punë progresive lidhur me të drejtat e minoriteteve. Në një konferencë të madhe ndërkombëtare Jean-Christian Cady, shefi i drejtësisë dhe policisë në UNMIK tha:

‘Kosova është një shembull i mirë për atë se çfarë mund të arrijnë komuniteti ndërkombëtar dhe Kombet e Bashkuara për të ndaluar pastrimin etnik dhe për ndërtim të instrumenteve politik që do të parandalojnë një rishfaqje të tyre të sërishme’.

Dhuna kundër grupeve etnike duket se ka rënë. Një komplet i 'standardeve' të njohura për Kosovën që duhet arritur para bisedimeve të ardhshme është vendosur në vitin 2003, përfshirë këtu edhe mbrojtjen e plotë të të drejtave të njeriut. Megjithatë, ajo që vendimmarrësit ishin duke injoruar ishte se problemet e mëdha nuk ishin zgjidhur ende. As UNMIK-u dhe as KFOR-i nuk kishin siguruar se grupet minoritare do të mund të ushtronin të drejtën e tyre për të jetuar lirshëm në Kosovë, dhe vetëm disa mijëra persona ishin kthyer në Kosovë. Kosova ngeli në mënyrë fundamentale një shoqëri e segreguar. Madje edhe Standardet nuk filluan nga pozita e përfundimit të segregacionit në shoqërinë kosovare, që shihej si gati se e paevitueshme.

Paralajmërimet për këtë gjë nga trupat si që është Ombudspersoni u injoruan në masë të madhe. Dështimi i policive të UNMIK-ut dhe KFOR-it në mënyrë dramatike u tregua nga një valë e pastrimit etnik në mars të vitit 2004, gati se pas pesë viteve pasi që autoritetet ndërkombëtare ndërmorën përgjegjësinë për Kosovën. Dhuna filloi pas raportimit të vdekjes së tre fëmijëve shqiptarë dhe një adoleshenti serb. Brenda orëve, grupe të shqiptarëve të rinj sulmuan komunitetet serbe, rome dhe ashkalinje nëpër Kosovë. Në atë që më vonë Kofi Annan do ta përshkruante si një 'kampanjë të organizuar, të gjerë dhe të targetuar', u dogjën shtëpi dhe kisha. Serbët, romët dhe ashkalinjtë ikën nga Kosova dhe kjo mund të quhej, njëllonj si në vitin 1999, një pastrim etnik. Një shembull goditës ishte largimi i gati se të gjithë komunitetit të mbetur serb në Fushë Kosovë. Dhuna la pas 19 të vdekur, 954 të lënduar, 4.100 persona të zhvendosur, 550 shtëpi të shkatërruara, dhe 27 kisha ortodokse dhe manastire të djegura.

Ajo që ishte gjithashtu mjaft e dukshme ishte dështimi gati se i tërësishëm i UNMIK-ut dhe KFOR-it për të parandaluar një gjë të tillë. Kjo ishte shumë e ngjashme me ngjarjet e vitit 1999. Edhe pse KFOR-i deri në vitin 2004 kishte 18.000 trupa në vend të një numri që duhej të arrinte mbi 40.000, tani kishte vite të eksperiencës në Kosovë. UNMIK-u kishte një administratë plotësisht funksionuese dhe shërbime policore (këto të fundit përbëheshin nga policia ndërkombëtare e UNMIK-ut dhe Shërbimi Policor i Kosovës). Megjithatë raporte të ndryshme, të shpaluara në shumë detaje nga Human Rights Watch, tregon minoritetet që thonë se kur ata kanë kërkuar asistencë, forcat e sigurisë të UNMIK-ut dhe KFOR-it nuk kanë ardhur, ose nëse kishin ardhur, vinin me vonesë dhe thoshin që mund të evakuonin minoritetet por jo të mbronin ato. Përveç kësaj katastrofe, komuniteti ndërkombëtar vazhdoi të refuzonte që të mësonte dhe të aplikonte leksione bazike, kryesisht nevojën për përgjegjshmëri efektive dhe përndjekje të krimeve të këtilla. Në vend që të merrte një përgjegjësi të këtillë, faji ju hidhej tërësisht politikanëve kosovarë. Brenda administratës ndërkombëtare ka pasur një përpjekje për parandalim të përdorimit të termit 'pastrim etnik'. Standardet u miratuan, duke theksuar se 'Askush nuk është mbi ligjin', dhe një pjesë e madhe e pronës së djegur u rindërtua. Megjithatë, edhe një herë çështjet kryesore që shkaktonin segregacion nuk u adresuan. Dy vite më vonë, vetëm, disa njerëz u dënuan për krime që ndodhën në mars të vitit 2004 dhe ata që u dënuan janë dënuar në një masë të vogël. Njëra nga arsyt kryesore për këtë është theksuar se përgjigja e komunitetit ndërkombëtar ka qenë të themelohet një njësi të veçantë policore ndërkombëtare (në një sistem juridik që do të ishte i bazuar në drejtësi, në hetim përndjekës). Kjo njësi u shkatërrua në janar të vitit 2005 për shkak të joefektivitetit.

Vendimet kryesore të marra nga komuniteti ndërkombëtar në përgjigje të pastrimit etnik ka qenë të vendosë për zgjidhjen e statusit të ardhshëm të Kosovës, por pa asnjë garancion paraprak për të drejtat e minoriteteve. Dy vite më pas, segregacioni

në Kosovë është rrënjësuar edhe më fortë se kurdoherë tjetër, dhe pastrimi etnik i vitit 2004 nuk është kthyer mbrapsht.

Çështje tjera Siguria

‘Palët ndërmarrin që të marrin masa të përshtatshme për mbrojtjen e personave që mund të jenë subjekt i kërcënimeve ose akteve të diskriminimit, armiqësisë ose dhunës si rezultat i identitetit të tyre etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar’.

Në Kosovë, çështja kritike për shumicën e minoriteteve ka qenë siguria e përditshme. Dhuna e organizuar, ngacmimet dhe sulmet ndaj pronës kanë filluar që nga fillimi i administratës ndërkombëtare dhe kanë vazhduar deri më sot. Minoritetet nuk ndjehen të mbrojtur në mënyrë adekuate nga ana e autoriteteve në Kosovë. Siç është përshkruar më sipër, pastrimi etnik sistematik dhe i organizuar ndodhi në vitin 1999 dhe në vitin 2004, por gjatë gjithë kohës pasiguria e vazhdueshme ka qenë kronike. Ajo që është kritike nuk është vetëm pasiguria aktuale por gjithashtu edhe perceptimi i minoriteteve lidhur me atë nëse ata mund të jenë të mbrojtur në mënyrë adekuate.

Kur shqyrtojmë çështjen e sigurisë gjatë viteve mund të thuhet se ajo ka ardhur valë - valë. Pas valës së parë të sulmeve në vitin 1999, autoritetet ndaluan me një reduktim kah fundi i vitit 1999. kjo u ndoq nga një shfaqje tjetër e dhunës në shkurt të vitit 2000, duke pasuar një sulm të autobusit të UNHCR përplot me minoritetet. Më vonë gjatë atij viti, numri i sulmeve ra, që ishte një sukses. Edhe një herë kjo u pasua me një valë të re të sulmeve ndaj minoriteteve, kryesisht me bombardimin e autobusit të “Nish ekspresit” që transportonte serbë në shkurt të vitit 2001, në të cilin sulm u vranë 10 persona. Një reduktim i mëtejshëm i dhunës në vitin 2003 përfundoi me sulme në mars të vitit 2004 si që u shpalua më sipër. Duket se, gjatë kësaj periudhe, janë organizuar sulme të ndryshme. Në asnjë kohë askush nuk mund të flasë për një situatë normaliteti, duke pasur minoritete që janë ndjerë në mënyrë adekuate të sigurt dhe të mbrojtur.

Përveç frikës së përditshme iu është shkaktuar minoriteteve duke i detyruar që të lëshojnë shtëpitë e tyre dhe, nëse kanë ngelur në Kosovë, janë mbledhur në enklava mono-etnike, një rezultat kritik ka qenë restriksioni i lirisë së lëvizjes. Minoritetet kanë qenë të frikësuar që të lëvizin lirshëm, dhe kanë pasur nevojë për eskortë që të bëjnë një gjë të tillë. Përsëri, përveç dhunës së të drejtave fundamentale, kjo ka bërë që për ata të jetë mjaft i vështirësuar qasja në punësim dhe shërbime, përfshirë këtu shëndetësi, arsim dhe asistencë sociale. Për afër shtatë vite, autoritetet ndërkombëtare nuk kanë mundur të gjejnë politika që do të çojnë kah një rritje permanente dhe e qëndrueshme në sigurinë e minoriteteve. Përgjigjet janë penguar nga mungesa e koordinimit dhe përgjegjësisë konfuze lidhur me sigurinë. Në vitet 1999 – 2000, një çështje kritike ka qenë dështimi i të gjitha shteteve që të sigurojnë polici adekuate – policia e UNMIK-ut nuk u mbush plot me personel deri kah fundi i vitit 2000. si që është theksuar më sipër, KFOR-i nuk u bë subjekt i kontrollit civil, prandaj ai ka operuar në mënyrë të pavarur. Në të njëjtën kohë, dhe siç duket kjo ka qenë kritike, vite me radhë kosovarëve nuk u është dhënë përgjegjësia për sigurinë. Shërbimi Policor i Kosovës u themelua shpejt dhe ka një dosje të mirë të rekrutimit të minoriteteve. Megjithatë kalimi i pushtetit këtij organi ka shkuar mjaft ngadalë. UNMIK-u ka mbajtur kontrollin direkt për sigurinë (policinë) dhe drejtësinë, madje edhe pas krijimit të IPVS. Ngjashëm, themelimi i një sistemi të drejtësisë ka kërkuar një kohë mjaft të gjatë.

Prandaj nuk është e papritshme se përgjigja e autoriteteve për nevojat e minoriteteve ka qenë jonkonsistente. KFOR-i, i cili përbëhet prej armatave, dhe jo forcave policore, fillimisht siguroi punkte kontrolluese, patrulla dhe eskorte. Kjo u kërkua nga ana e minoriteteve. Janë bërë përpjekje për t'u marrë me çështjen e lirisë së lëvizjes duke ngritur rrugë të reja dhe, gjatë një periudhe, UNHCR-ja ka qarkulluar një shërbim autobusi për minoritetet. Më vonë, megjithatë, KFOR-i i largoi shumicën e instalimeve të veta permanente pasi që numri i trupave u reduktua.

Disa ligje të reja janë miratuar në përpjekje për të adresuar mërinë etnike dhe për të bërë akuzimet në mënyrë më të lehtë. Rregullorja e parë për ndalimin e nxitjes së mërisë racore megjithatë është përdorur mjaft rrallë, pasi që konsiderohet se është draftuar jo ashtu siç duhet – duket se UNMIK-u nuk ka përdorur asnjë nga modelet e shumta të disponueshme në pjesën e ngelur të Evropës. Komisionari i Përkohshëm për Media në Kosovë nuk ka marrë veprime për të dënuar gazetatat për mëri racore, por përsëri duket se nuk ka pasur një qasje të koordinuar.

Efkti i masave militare që janë ndërmarrë janë bërë për të rforcuar segregacionin. Përveçse nëse qëllimi është që Kosova të jetë përjetësisht e ndarë në kampe të armatosura, masat që i ndajnë komunitetet nuk mund të jenë më shumë se një zgjidhje e përkohshme. Problemet aktuale duhet të adresohen por deri më tani ata nuk janë adresuar. Dhe më e rëndësishmja, përveç evidencave të mëdha të natyrës së organizuar të pastrimit etnik dhe dhunës, asnjë lider nuk ka qenë i përndjekur. Derisa vetëm disa njerëz janë ndjekur për sulm ndaj minoriteteve, këto masa kanë qenë të një niveli të ulët. Si që është theksuar më sipër, qasja duket të ketë qenë për të emëruar në pushtet ata që kanë qenë të akuzuar për organizim të dhunës. Që nga viti 1999 ka pasur supozime se përpjekjet për të hetuar dhe arrestuar figura të larta në Kosovë kanë qenë të parandaluara për shkaqe politike.

Segregacioni dhe diskriminimi

Respektimi i të drejtave të minoriteteve ka për qëllim një shoqëri ku të gjithë mund të flasin gjuhën e vet, dhe të praktikojnë fenë dhe kulturën e tyre pa mos vuajtur çfarëdo të keqe. Kjo do të thotë shoqëri të integruara, jo shoqëri që janë në mënyrë të vrazhdë të ndara nga etniciteti apo feja. Më e keqja mund të jetë ndarja që ka për qëllim krijimin e zonave mono-etnike. Gati se gjithmonë, të drejtat e minoriteteve brenda zonave të këtilla janë të limituara. Forma më e mirë për një stabilitet afatgjatë në një shoqëri është integrimi duke respektuar diversitetin. Kjo kërkon masa efektive për të tanguar diskriminimin dhe për të siguruar se të gjitha grupet kanë akses në shërbimet publike dhe punësimi në një bazë të barabartë.

UNMIK-u dhe KFOR-i kanë bërë shumë pak për të ndërmarrë masa për krijimin e një shoqërie të integruar. Pas pastrimit etnik të marsit të vitit 2004, PSSP i atëhershëm tha 'Koncepti i Kosovës multi-etnike të cilën në mënyrë konsistente është munduar që ta implementojë komuniteti ndërkombëtar, në vitet e fundit tani më nuk është i arsyeshëm.' Në fakt komuniteti ndërkombëtar, pas disa përpjekjeve në fillim të këtij misioni, asnjëherë nuk është munduar që të krijojë një Kosovë të integruar që lejon që të gjithë njerëzit të jetojnë të lirë.

Në vend të kësaj politikat e miratuara në mënyrë efektive kanë rforcuar ndarjen e Kosovës në zona të shqiptarëve dhe të serbëve, me shërbime të ndara përputhshmërisht. Minoritetet tjera janë trajtuar si klasë i dytë.

Pastrimi etnik i vitit 1999 çoi kah zonat shqiptare dhe serbe. Në një bazë të përkohshme, ruajtja e ndarjeve të këtilla duhet të ketë bërë të mundshme mirëmbajtjen më të lehtë të sigurisë. Është bërë shumë pak për ndalimin e ndarjeve të këtilla. Nga

viti 1999, UNMIK-u dhe KFOR-i kanë lejuar që të gjitha aspektet e Kosovës të jenë të ndara. Kjo është parë më pastër në shërbimet publike si që janë shëndeti dhe arsimiti. Në korrik të vitit 1999, shumica e serbëve dhe stafit tjetër të minoriteteve në spitalin e Prishtinës u larguan, duke pasuar një numër të madh ët rasteve të frikësimit dhe ngacmimit. Raportet për një trajtim të varfër të minoriteteve kanë qenë të numërta.

Në spitalin e Mitrovicës që u shndërrua në një zonë të serbëve, stafi shqiptar dhe pacientët shqiptarë maltretoheshin, ndërsa lideri serb në mënyrë publike tha se nuk duhet të ketë shqiptarë në spital. KFOR-i u provua të jetë i paaftë që të bëjë çfarëdo lidhur me këtë dhe të gjithë shqiptarët lëshuan spitalin në shtator të vitit 1999. 63 pacientë serb u përjashtuan nga spitali i Gjilanit në shtator të vitit 1999. në vend të adresimit të çështjes së diskriminimit nëpër spitale, autoritetet preferuan që të lejojnë zhvillimin e sistemeve të ndara. Për shembull, pasi serbët ishin në pamundësi që të shfrytëzojnë spitalin e Prishtinës, u themelua një objekt shëndetësie në fshatin serb të Ulpianës.

Sistemi arsimor, i ndarë që nga viti 1990, është bërë edhe më i ndarë. Njëlloj si edhe me një numër të madh të çështjeve nuk është bërë asnjë përpjekje për të imponuar integrimin. Politika e përgjithshme ideale fillestare e UNMIK-ut duket të ketë qenë me qëllim “dy shkolla nën një kulm”, në të cilin grupet e ndryshme ndajnë ndërtesën por kanë klasa të segreguara. Kjo në vetvete është shumë larg nga idealja pasi që promovon segregacion, me njohuri të ndryshme të historisë, gjuhës dhe kulturës. Por edhe ka kjo ka qenë e pamundshme që të vendoset. Në Mitrovicë, UNMIK-u ka shpallur shkolla të përziera në shtator të vitit 1999. megjithatë, pas një vale dhune të filluar nga serbët në përgjigje, politika u suspendua vetëm një javë më pas, duke treguar edhe një herë se autoritetet ndërkombëtare frikësoheshin nga dhuna. Shqiptarët ikën me pajisjet në jugun e një gjendjeje më të keqe se sa ajo që mbretëronte në veri. Në Prizren, edhe boshnjakët edhe turqit raportonin maltretime dhe mohim të arsimit në gjuhën e tyre. Deri më vitin 2000, fëmijët romë, ashkalinjë dhe egjiptas ende nuk ishin duke pranuar ndonjë farë arsimimi. Vajzat romë vuanin në mënyrë disproporcionale. Një sistem i strukturave paralele, ku shkollat serbe në mënyrë efektive udhëhiqen nga autoritetet serbe, është toleruar si një mënyrë e sigurimit të modusit për shërbime publike në shkolla.

Në punësim, minoritetet i humbën punët tejmase në vitin 1999. Përpjekjet për të përmirësuar këtë gjendje kanë qenë shumë të limituara, dhe shpesh herë kanë qenë të restriktuara në kuota strikte. Diskriminimi masiv, për shembull, raportohet kundër romëve gjatë marrjes në punë nga ana e punëdhënësve privat dhe publik, ndërsa shumë pak është bërë për të adresuar këtë çështje. Të paktën një romi i është thënë se punët për ‘minoritetet’ u dedikohen vetëm serbëve.

Që nga viti 1999, është bërë shumë pak për të shkatërruar këtë ndarje. Dhe më e rëndësishmja, nuk ka pasur një strategji të qartë anti-diskriminuese. Hapi i vetëm i sigurt ishte miratimi i Ligjit Antidiskriminim në shtator të vitit 2004. kjo ngjarje ishte njëra prej shembujve të rrallë ku ka pasur bashkëpunim në mes të organizatave ndërkombëtare dhe qeverisë kosovare dhe ku janë përdorur praktikat më të mira ndërkombëtare. Forca fillestare për këtë ligj erdhi nga OSBE-ja, e cila filloi të bëjë shtypje për një ligj të këtillë në vitin 2000. ligji në masë të madhe u përgatit nga OSBE-ja dhe Zyra e Kryeministrit. Mbështetej në masë të madhe në standardet dhe eksperiencat e UE-së. Për arsye politike, partija kryesore serbe në Parlament kundërshtoi krijimin e një trupi të pavarur për të ndihmuar fuqizimin e ligjit. Përveç kësaj, ligji në përgjithësi është i mirë. Është njëra prej fushave të pakta ku Kosova ka miratuar ligje dhe politika para pjesës tjetër të Evropës, duke u bazuar në kuptimin e asaj që është duke funksionuar në vende tjera.

Ligji mezi është implementuar, edhe përkundër një obligimi për të vepruar në këtë mënyrë sipas Planit për Implementim të Standardeve. Vetë OSBE-ja prodhoi një plan për implementimin e tij dhe organizoi trajnime për gjyqtarë. Megjithatë ekziston shumë pak evidencë për një implementim sistematik dhe ndryshim të politikave në mesin e zyrtarëve shtetëror, dhe nuk është sjellur të paktën një rast juridik. Gati dy vite pas miratimit të ligjit, IPVQ më në fund ka prodhuar një plan për implementimin e tij.

Prona

Me pastrimin etnik dhe zhvendosjen gati permanente të minoriteteve nga dhe brenda Kosovës, çështjet pronësore kanë qenë në mesin e më kryesoreve. Këto çështje paraqiten në tre fusha kryesore.

E para është okupimi ilegal i shtëpive që më parë kanë qenë në pronësi ose kanë qenë të okupuara nga minoritetet. Kjo ndodh kryesisht nëpër qytete. E dyta është shkatërrimi i shtëpive të poseduara nga minoritetet (kryesisht në fshatra), shpesh të përcjella me ndërtime ilegale. Të dyja këto çështje duhet të adresohen para shpresës që minoritetet të kthehen.

Çështja e fundit kryesore është orvatja e vazhdueshme për t'i përzënë minoritetet nga pjesë të caktuara të Kosovës përmes shitjes së detyrueshme – d.m.th. targetimi i zonave dhe shtëpive të minoriteteve dhe maltretim i pronarëve deri sa ata të shesin shtëpitë e tyre, shpesh herë për çmime shumë më të ulëta se sa vlera normale e tregut. Kjo ka qenë një komponentë kritike e largimit të vazhdueshëm të minoriteteve nga provinca.

Përgjigja ndërkombëtare për të sipër cekurën ka lënë shumë gjëra për t'u dëshiruar. Në mars 2004, pas gati pesë viteve të qeverisjes, UNMIK-u theksoi se 'të drejtat në pronën e paluajtshme në Kosovë nuk janë të respektuara ose mbrojtura në mënyrë të mjaftueshme'. Kthimi i pronës së okupuar kërkon dy hapa: e para që e gjithë prona duhet që në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe legale t'i jepet pronarit të ligjshëm, dhe pastaj që pronari të lejohet ta përdorë pronën e vet në mënyrën që ai dëshiron dhe, më kryesorja, që çdo okupues ilegal të dëbohet.

Komuniteti ndërkombëtar, duke pretenduar të aplikojë leksionet e mësuara në Bosnjë, vendosi në vitin 1999 se gjyqet e rregullta kosovare nuk mund të merreshin me pretendimet pronësore. Në vend të kësaj, u themelua një sistem i komplikuar që involvonte Drejtorinë për Banim dhe Pronësi (DBP) dhe Komisioni për Kërkesa për Banim me qëllim që të merret me kërkesat pronësore banesore. Megjithatë, ky trup ishte në mënyrë kronike pak i financuar që nga fillimi, veçanërisht kur krahasohet me gjyqet e rregullta me projekte të vogla të kthimit ose me shumat e mëdha të parave të shpenzuara nga komuniteti ndërkombëtar për zgjedhje. DBP nuk hapi zyrën e vet në rajonin e Prizrenit (që përfshin një të pestën e Kosovës) deri në shkurt të vitit 2003. U vendosën vetëm disa aranzhime speciale për të siguruar se minoritetet mund ta shfrytëzonin në mënyrë të lirë sistemin. Gjatë dhënies së titujve pronësor, policia e KFOR-it dhe UNMIK-ut refuzonin që të bënin urdhra për dëbim duke u frikuar nga mosrehatia.

Lidhur me çështjen e rikonstruimit të shtëpive të shkatërruara, disa nga shumat e mëdha të parave për asistencë shkuan për këtë çështje vitale. Por nuk duket të ketë qenë menduar ose planifikuar mirë. Në një moment shtëpitë e minoriteteve ishin rikonstruuar por pastaj menjëherë u dogjën. Në mënyrë skandaloze, Agjencioni Evropian për Rikonstruim (EAR) insistoi që të gjitha projektet të përcaktoheshin nga autoritetet komunale, edhe përkundër evidencës së madhe se shumica e këtyre autoriteteve ishin të anshme kur bëhej fjalë për serbët dhe minoritetet tjera. Rezultati

ishite se në vitin 2000 vetëm 2 për qind e asistencës së EAR-it shkoi për minoritetet ndërsa në vitin 2001 vetëm 3.7 për qind. Agjencionet që financonin dhe zhvillonin projekte rikonstruimi dështuan që të kuptojnë dhe aplikojnë konceptin e diskriminimit indirekt. Politikat e tyre, për të cilat thoshin se i trajtonin të gjithë njëllë, i dha fund diskriminimit kundër minoriteteve. Një shembull i kësaj ishin agjencitë rikonstruuese që kërkonin nga çdokush që kërkonte asistencë që të prezantohej personalisht, përkundër asaj se shumë minoritete ishin jashtë Kosovës ose kishin restriksione të mëdha të lirisë së lëvizjes.

Përfundimisht, nëpër Kosovë, minoritetet e gjetën veten nën presion për të shitur shtëpitë. Në rrënjën e këtij problemi shtrihet frika e minoriteteve për sigurinë e tyre. Duke mos pasur besim se do të mbrohen nga autoritetet, ata iu dorëzuan presionit që të shesin shtëpitë në mënyrë që të bëjnë para për të filluar një jetë të re diku tjetër. Në disa pjesë të Kosovës dukej të ketë pasur një orvatje të fokusuar për të detyruar minoritetet që të shesin. Gjatë këtyre viteve kjo dukej, për shembull, veçanërisht e përbashkët në mesin e serbëve në Fushë Kosovë. OSBE-ja dhe UNHCR-ja përshkruan se çfarë do të ndodhte: meshkujt e rinj shqiptarë do të vizitojnë një shtëpi serbe dhe në mënyrë të kulturuar do të ofrojnë që ta blejnë atë. Nëse ata do të refuzonin, pas një kohe shtëpia do të prishej. Burri do të kthehej me një ofertë më të ulët. Përsëri, nëse edhe kjo ofertë refuzohej, prishja do të vazhdonte derisa serbi do ta shiste shtëpinë. Shtëpitë e këtilla në mënyrë të qëllimshme targetoheshin që serbët e ngelur të ndjeheshin të pambrojtur.

Përgjigja e autoriteteve ishte që ta bëjë situatën e minoriteteve edhe më të keqe, duke i dhënë administratorëve komunale të UNMIK-ut pushtet që të refuzojnë të regjistrojnë shitje ndëretnike të shtëpive. Siç duket kjo bëhej me qëllim që të ndalojë ikjen e vazhdueshme të minoriteteve nga pjesë të mëdha të Kosovës. Megjithatë, konsultimet e brendshme brenda UNMIK-ut shfaqën një kundërshtim të një shkalle të lartë ndaj kësaj. U theksua se kjo shkelte të drejtat e minoriteteve mbi pronën e tyre, ishte diskriminuese pasi që aplikoheshin vetëm në zonat e minoriteteve, dhe e bënte situatën e minoriteteve edhe më të keqe pasi që ata herë si do të iknin, duke mos qenë në gjendje që të shesin shtëpitë e tyre, dhe nuk do të kishin para. Mbi të gjitha, kjo gjë adresonte një simptomë dhe jo një shkak të problemit, që ishte mungesa e sigurisë së minoriteteve. Përkundër kësaj, ligji u përshpejtua nga ana e UNMIK-ut me kërkesën e liderëve serb, të cilët kërcënoheshin me bojkotim të zgjedhjeve të vitit 2001. Ka qenë e lehtë të parashikohet efekti. Serbët megjithatë e lëshuan Kosovën, pasi që ende ballafaqoheshin me kërcënime të sigurisë, por tani gjetën veten pa para pasi që nuk ishin në gjendje që të shesin shtëpitë e tyre. Në fakt, duket që frika dhe pasiguria lidhur me këtë ligj solli në një rritje, dhe jo një reduktim, në shitjen e shtëpive të minoriteteve. Politikat afatshkurtra përsëri morën prioritet mbi të drejtat e anëtarëve të minoriteteve dhe ardhmërinë e tyre afatgjatë.

Participimi

‘Palët do të krijojnë kushte të domosdoshme për participim efektiv të personave që u takojnë minoriteteve kombëtare në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike dhe në punët publike, në veçanti lidhur me ato çështje që ndikojnë ndaj tyre.’

Komuniteti ndërkombëtar, si në vende të tjera të botës, theksonte zgjedhjet si zgjidhja për problemet e Kosovës. Shuma të mëdha të parave dhe kohës u harxhuan në organizimin e zgjedhjeve komunale në vitin 2000 dhe zgjedhjet për Parlamentin e Kosovës në vitin 2001 (të përsëritura në vitin 2002 dhe 2004 respektivisht). Rëndësia

e e sigurimit të participimit të minoriteteve u njoh në një masë të caktuar. Përfaqësimi i minoriteteve garantohej në autoritetet komunale dhe në Parlamentin e Kosovës. Megjithatë, duket që në raundin e dytë të zgjedhjeve komunale, përfaqësimi i minoriteteve ra në mënyrë domethënëse.

Parlamenti ka një sistem të komplikuar të përfaqësimit të minoriteteve. Duket se deri në njëfarë mase ka kopjuar atë të Bosnjës, bazuar në vende të garantuara për grupe të caktuara minoritare. Garantohen 10 vende për serbët dhe 10 për minoritetet 'tjera', të ndara në përputhshmëri me madhësinë relative të komunitetit (romët/ashkalinjtë/egjiptasit kanë katër vende, boshnjakët tre, turqit dy dhe goranët një). Minoritetet gjithashtu janë të lirë që të kandidohen për në parlament sipas sistemit të rregullt elektoral. Ajo që sistemi nuk mund të adresonte, ishin, sigurisht bojkotimet e e grupeve minoritare. Në vitin 2000, serbët në mënyrë masovike i bojkotuan zgjedhjet komunale. PSSP emëroi pastaj serbë në një numër të madh të autoriteteve komunale. Në vitin 2001 serbët participuan, duke votuar për partinë e quajtur Povratak (Kthimi), e cila participoi në Parlament. Në vitin 2004 qeveria e Serbisë thirri për bojkotim të zgjedhjeve për parlamentin e Kosovës, dhe qytetarët serb masovikisht iu përmbajtën këtij apeli.

Ajo që ka qenë pozitive lidhur me participimin është se me këtë është tejkaluar përfaqësimi i thjeshtë në asamble dhe është bërë përpjekje për të siguruar përfaqësim të minoriteteve në qeveri. Këshilli fillestar i Përkohshëm Administrativ JIAS (katër persona) më në fund përfshiu edhe një serbe, Rada Trajković, ndërsa katër bashkudhëheqësit e departamenteve (ministrive) ishin nga minoritetet. Korniza Kushtetuese siguron që, nga shtatë anëtarët e Presidencës së Asamblesë, njëri prej tyre do të jetë nga radhët e partisë së serbëve të Kosovës dhe një nga partia që përfaqëson 'shqiptarët jashtë Kosovës dhe serbët jashtë Kosovës'. Gjithashtu kërkohet që Parlamenti duhet të krijojë Komitet për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve me dy anëtarë nga secili komunitet në Parlament, që mund të shqyrtojë propozim ligje në dritën e interesit të komuniteteve. Duhet që së paku dy ministri (tre ministri nëse ka më shumë se 12 gjithsej) të jenë nga 'Komunitetet tjera që janë të ndryshme nga komuniteti që e ka përfaqësimin mazhoritar në Parlament', ndërsa njëri prej këtyre ministrive duhet t'u takojë serbëve dhe tjetri 'komunitetit tjetër'. E gjithë kjo është zbatuar.

Në nivel komunal. Rregullorja 2000/45 kërkonte që çdo autoritet komunal duhet të themelojë një Komitet të Komuniteteve dhe një Komitet për Ndërmjetësim në mënyrë që të përfaqësohen interesat e minoriteteve. Megjithatë, efektiviteti i këtyre trupave ka qenë mjaft i limituar. Është kështu pasi që nuk ka pasur udhëzime qendrore. Megjithatë, e drejta e minoriteteve është e drejta e çdo anëtari të minoritetit 'për participim efektiv në vendime që i ndikojnë ata'. Kjo nuk është arritur në Kosovë për një sërë arsyesh. E para, e drejta për participim ka qenë e drejta e liderëve minoritar për participim. Shumë vendime konsiderohet se janë marrë me involvim të 'participimit të minoriteteve' vetëm me konsultim të disa liderëve. Para vitit 2001, vetëm disa prej këtyre liderëve kanë mundur të pohojnë çfarëdo përgjegjësie demokratike, dhe bile edhe pas vitit 2001 nuk ka pasur një kulturë të përgjegjësive së liderëve. Janë bërë disa orvatje për t'u biseduar me vetë komunitetet, si që është Platforma për Veprim të Përbashkët të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve, por të gjitha këto kanë përfunduar jetëshkurtra dhe janë përbërë nga disa vizita që liderët u kanë bërë komuniteteve, pa një involvim të vazhdueshëm. Duhet të theksohet se shumica e liderëve të minoriteteve kanë qenë meshkuj.

Një shembull i keq i konsultimeve është draftimi i Kornizës Kushtetuese në vitin 2001. Me këtë u vendosën të drejtat e komuniteteve (minoriteteve) por të njëjtat

nuk u dhanë në një konsultim të përgjithshëm. Në vend të kësaj, e përpiloi një grup i vogël dhe sekret i njerëzve. Konsultimet e minoriteteve janë përbërë prej diskutimeve me disa liderë të serbëve. Një tjetër shembull kur liderët kanë bërë vendimet e tyre është ai i liderëve të partisë Povratak (Kthimi) për vënien e vetos ndaj krijimit të një trupi të pavarur për implementim të ligjit antidiskriminim. Ky vendim u morr për shkak të politikës së përgjithshme të kundërshtimit të strukturave permanente në Kosovë, por ka qenë shumë pak në interes të serbëve. Në vitin 2003 OSBE-ja theksoi se përfaqësuesit e zgjedhur të minoriteteve kanë mungesë të përgjegjësisë ndaj elektoratit të tyre.

Edhe më e rëndësishme se kjo ka qenë fakti se, bile edhe sot, IPVQ e Kosovës ka shumë pushtet të kufizuar. Korniza Kushtetuese që themeloi IPVQ nuk thotë asgjë nëse ajo do të ndikojë ose do të zvogëlojë autoritetin e UNMIK-ut ose KFOR-it. PSSP ka pushtet të dominojë mbi IPVQ në çdo kohë. Ai gjithashtu ka pushtete specifike të rezervuara, përfshirë këtu: 'Autoritet të plotë për të siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve janë duke u mbrojtur në mënyrë të plotë', fuqizimin e drejtësisë dhe ligjit, dhe Drejtorinë për Banim dhe Pronësi. Është bërë një konfuzion lidhur me atë se kush për çfarë është përgjegjës; kështu ka përfunduar edhe Këshilli i Evropës:

'Kjo gjë në disa raste ka rezultuar në një situatë kur përgjegjësitë nuk janë supozuar qartësisht nga asnjëri prej autoriteteve të involvuara, dhe për individët është e vështirë që të identifikojnë një bashkëbisedues që do të adresojë shqetësimet e tyre legjitime.'

Për çështjet kritike të minoriteteve, veçanërisht sigurinë dhe banimin, vendimet janë marrë nga UNMIK-u dhe KFOR-i. Megjithatë minoritetet kanë qenë shumë pak të aftë që të participojnë në vendimmarrje. As UNMIK-u dhe as KFOR-i nuk kanë pranuar se janë sjellë si pushtet qeveritar në Kosovë. Kjo duket më së shumti në një rregullore të miratuar nga UNMIK-u në vitin 2000. kjo rregullore, që është aplikuar, pohon të jep një imunitet të tërësishëm UNMIK-ut dhe KFOR-it dhe stafit të tyre nga me përgjegjësinë juridike në Kosovë. Duke pasur parasysh se nuk është autoritet i zgjedhur, ata nuk kanë përgjegjësi zgjedhore. Dhe duke pasur parasysh se UNMIK-u në fillim refuzoi që të lejojë monitorim nga trupat ndërkombëtarë si Këshilli i Evropës, minoritetet deri vonë, nuk kanë qenë në gjendje ta mbajnë qeverinë e tyre të përgjegjshme ndërkombëtarisht.

Hera e parë kur UNMIK-u pranoi përgjegjësi ndërkombëtare ishte me pranimin e monitorimit të Këshillit të Evropës në përputhshmëri me Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare (FCNM). Ky ishte një hap i mirëpritur. Megjithatë, participimi i minoriteteve ka qenë deri në njëfarë shkalle i limituar. Në vend që ta kalojë udhëheqjen minoriteteve dhe qeverisë kosovare, edhe raporti edhe raporti nën hije u koordinuan nga OSBE-ja (sigurisht kjo është hera e parë që i njejti trup koordinon edhe një raport zyrtar edhe një raport nën hije). Raporti nën hije theksonte se roli i koordinatorit nuk ka qenë që të përpilojë, 'dhe as të imponojë influencë të jashtme'.

Minoritetet kanë dhënë ca kontribut në raportin nën hije, por Këshilli i Evropës është referuar në 'mungesën e kuptimit' të UNMIK-ut lidhur me çështjen e participimit. Në të vërtetë, vetë raporti nën hije thekson se 'praktika ideale gjatë procedurës së përpilimit të Raportit Zyrtar do të përfshijë konsultime me anëtarët e minoriteteve. Megjithatë në rastin e Kosovës kjo praktikë nuk është ndjekur.

Minoritetet nuk kanë qenë në gjendje që të ndikojnë në vendimet që ndikojnë në ata. Plani i UNMIK-ut për Implementimin e Standardeve për Kosovën nga marsi i

vitit 2004 theksonte se 'Është esenciale që institucionet e Kosovës ... të bëjnë më shumë progres duke lejuar participim të plotë të të gjitha komuniteteve.' Minoritetet janë ankuar në mënyrë konstante se ata nuk kanë pasur mundësi që të japin kontribut në vendimet e KFOR-it lidhur me politikat e sigurisë, që kanë qenë vitale për jetën e tyre. KFOR-i ka ndërruar politikat, kryesisht lidhur me reduktimin/largimin e prezencës permanente, pa mos bërë konsultime. Cilado që të jetë merita e këtyre vendimeve në vetvete, mungesa e konsultimeve ka çuar kah një ndjenjë e papushtëtshmerisë së plotë dhe pasigurisë në mesin e minoriteteve, duke pasur parasysh rrezikun në të cilën ndodheshin. Kjo mungesë e përgjegjësisë dhe aftësia për të influencuar në vendime ndikon të gjithë popullin e Kosovës. Megjithatë, duke pasur parasysh pambrojtshmërinë e minoriteteve, përfshirë këtu edhe lirinë e tyre të restriktuar të lëvizjes, minoritetet kanë qenë më të ndikuar se të tjerët. Një shembull tjetër i mungesës së konsultimeve me minoritetet është ligji për restriktimin e shitjeve strategjike.

Trupi i vetëm zyrtar që e mbante UNMIK-un përgjegjës është Ombudspersoni, një institucion i themeluar në vitin 2000. KFOR- i ka refuzuar të lejojë që Ombudspersoni të bëjë monitorimin e veprimeve të tyre. Megjithatë Ombudspersoni ka pushtet që të hetojë UNMIK-un dhe shumica e hetimeve të tij të përgjithshme dhe specifike kanë qenë lidhur më çështje të minoriteteve. Megjithatë Ombudspersoni i parë ka raportuar për një mosvullnet të përgjithshëm të UNMIK-ut që të përgjigjet e jo më të përmbushë gjtjet e tij. Pushteti i Ombudspersonit për të hetuar UNMIK-un në fakt u hoq në vitin 2006. Efekti ka qenë se UNMIK-u është bërë njëra prej qeverive më pak të përgjegjshme në botë, dhe edhe një herë minoritetet janë lënë të papushtetshëm për ta mbajtur qeverinë e tyre të përgjegjshme.

Një leksion i marrë nga konfliktet e shumta etnike dhe fetare është se participimi, veçanërisht në sistemin politik, duhet të involvojë më shumë se një përfaqësim të thjeshtë të kuotave. Sistemet politike të themeluara nga ata që nuk kuptojnë të drejtat e minoriteteve shpesh herë dështojnë që të adresojnë çështje të diskriminimit dhe supozojnë se kuotat strikte do të jenë të mjaftueshme. Në fakt, kuotat shpesh herë çojnë kah ndarja e ashpër në bazë të etnicitetit/fesë dhe bile mund edhe të reduktojnë të drejtat e minoriteteve pasi që të gjitha çështjet e minoriteteve u lehen përfaqësuesve të minoriteteve. Duket se nëse sistemi politik i themeluar nga UNMIK-u dhe OSBE-ja në Kosovë ka një paraardhës, këto janë institucionet e vendosura nga komuniteti ndërkombëtar në Bosnjë, njëra prej shoqërive më të ndara në botë. Sistemi boshnjak është vrazhdësish i ndarë sipas etnicitetit, me një sistem dyshtresor ku të tre 'popujt konstituent' kanë të drejta superiore dhe të gjitha grupet tjera quhen si 'të tjerë' dhe qartësisht i takojnë klasës së dytë. Edhe pse sistemi i Kosovës nuk i ripërsërit të gjitha këto gabime, megjithatë ka disa tipare të ngjashme. Edhe pse Korniza Kushtetuese nuk përdor termin zyrtar 'të tjerë', ajo implikon këtë termin, duke i trajtuar shqiptarë dhe serbët në mënyrë të ndryshme. Sistemi i kuotave ët ngurta nuk shoqërohet me masa për të siguruar se qeveria përfaqëson të gjithë kosovarët dhe për të siguruar respektim të të drejtave të minoriteteve.

Në mënyrë të barabartë e rëndësishme është edhe vëmendja që duhet kushtuar nevojave të femrave nga minoritetet. Komuniteti ndërkombëtar ka vendosur disa sisteme të kuotave për të siguruar se përafërsisht 30% e zyrtarëve të zgjedhur janë femra. Megjithatë, në qeverinë e parë të emëruar nga Parlamenti i Kosovës në vitin 2001, asnjë ministër nuk ishte femër. Ky ka qenë një problem i përgjithshëm. Në një raport deri te Këshilli i Sigurimit në janar të vitit 2004, Sekretari Gjeneral theksoi se:

'Institucionet e Përkohshme ende kanë një evidencë të varfër të femrave në pozita të larta drejtuese. Prezenca e femrave në trupat legjislativ reflekton vetëm

kërkesat e minimumit juridik për përfaqësim gjinor në listat elektorale, duke pasur femra në 33 nga 120 vendet në Parlamentin e Kosovës dhe 28% të vendeve të të gjitha parlamenteve komunale. Në sektorin publik, ka vetëm një femër ministre nga numri i përgjithshëm 10, 1 femër sekretare e përhershme nga gjithsej 9, 7 femra udhëheqëse nga gjithsej 18 dhe vetëm 2 femra shefe të ekzekutivit nëpër komuna nga gjithsej 30.'

Femrat nga minoritetet megjithatë shpesh herë kanë qenë më të njohura, përfshirë këtu edhe anëtarin e parë serbe të KPA, sesa grupi më i lartë ekzekutiv i kosovarëve. Në Parlamentin e vitit 2001, njëra nga anëtarët më të njohura ishte gruaja e re turke e cila u bë anëtare e Presidencës së Parlamentit dhe kryesonte Komitetin për Shëndetësi. Megjithatë, ajo nuk u zgjodh nga partia e saj për zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Ka shumë pak evidencë për çfarëdo pune specifike të bërë nga autoritetet për të zbuluar dhe adresuar nevoja të caktuara të femrave minoritare. Në mars të vitit 2006, u formua një grup i quajtur Koalicioni i Femrave për Paqe, që përbëhej nga femra të grupeve të ndryshme etnike. Ky koalicion ka lobuar për përfshirje të femrave në diskutimet për statusin, duke theksuar se shtatë përfaqësuesit kosovarë janë të gjithë meshkuj.

U bënë disa orvatje, edhe pse graduale, për të sjellë në një vend bashkë organizatat e femrave shqiptare dhe serbe. Megjithatë, UNIFEM (Fondi i KB-së për Femrat) raportoi se këto orvatje u thyen pas dhunës së vitit 2004.

Ndërthurja e diskriminimit gjinor dhe ndaj minoriteteve nuk u njoh tërësisht në ligjin antidiskriminim. Edhe pse plani inicial ishte krijimi i një ligji gjithëpërfshirës që do të adresonte diskriminimin sipas të gjitha bazave, në vend të kësaj u miratua një ligj për 'Barazi Gjinore', i ndarë nga zhvillimi i ligjit antidiskriminim i cili aspak nuk thekson minoritetet.

Gjuha

Një çështje kritike për shumicën e minoriteteve është ajo lidhur me gjuhën. Është bërë shumë punë në nivel ndërkombëtar lidhur me atë se çfarë do të thotë e drejta për të folur gjuhën e parë. Disa rekomandime më të detajizuara dhe një notë shpjeguese e gjatë është miratuar nga OSBE-ja – Rekomandimet e Oslos. Këto rekomandime u bazuan në njohuritë e ekspertëve dhe eksperiencës së gjatë të punës në lidhje me çështje të gjuhëve nëpër Evropë.

Në Kosovë, gjuhët zyrtare sipas Kushtetutës së vitit 1974 kanë qenë serbo-kroatishtja, shqipja dhe turqishtja. Komuniteti ndërkombëtar u ballafaqua me një situatë të vështirë lidhur me atë se deri në çfarë mase duhet të njiheshin, mbroheshin dhe përdorreshin gjuhët minoritare. Megjithatë, deri në vitin 2000 OSBE-ja dhe UNHCR-ja raportuan se politika për gjuhët ishte ende konfuzë dhe shumë larg nga të qenit uniforme.

Shumë është bërë në letër. Rregullorja për Autoritetet Komunale në vitin 1999 kërkoi që të përdoren edhe gjuha shqipe edhe serbe. Korniza Kushtetuese vendos të drejta ekstensive për minoritetet në Kapitullin 4, duke theksuar se:

'Komunitetet dhe anëtarët e tyre do të kenë të drejtë të:

- a) *Të përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre lirshëm, përfshirë këtu edhe para gjyqeve, agjencive, dhe trupave të tjera publike në Kosovë*
- b) *Të marrin arsimim në gjuhën e tyre*
- c) *Të gëzojnë qasje në informata në gjuhën e tyre*

....

- i) *Sigurojnë informata në gjuhën dhe alfabetin e komunitetit të tyre, përfshirë edhe themelimin dhe mirëmbajtjen e mediave të tyre ...*
- o) *Do t'u garantohet qasje dhe përfaqësim në mediumet publike si dhe program në gjuhët relevante ...* ‘

Këto të drejta shkojnë shumë larg standardeve ndërkombëtare dhe, në të vërtetë, nga ata standarde që aplikohen në vende të tjera, pasi që aplikohen ndaj të gjitha komuniteteve në çdo kohë dhe në çdo vend. Janë bërë shumë përpjekje nga ana e UNMIK-ut për përkthimin e të gjitha dokumenteve.

Në fakt, problemet lidhur me këtë çështje të veçantë janë të pazakonta. Së pari, është bërë shumë pak për të ndaluar palët e treta që të restrikojnë të drejtën e personit që të përdorë gjuhën e vet në publik, përfshirë këtu edhe shkatërrimin dhe largimin e shenjave, dhe bile edhe të kërcënimeve dhe dhunës kundër personave që flasin gjuhën e ‘gabuar’ në publik. Kjo ka qenë në mënyrë esenciale një çështje sigurie, por një përpjekje për të kërkuar nga autoritetet komunale që të mbrojnë shenjat u largua nga Rregullorja e vitit 1999 gjatë fazës së përpilimit.

Një çështje tjetër ka qenë segregacioni bazik i Kosovës, ndërsa preferencat u janë dhënë shqiptarëve dhe serbëve. Gjuhët tjera janë trajtuar si të klasës të dytë, ndërsa turqit në veçanti janë ankuar për degradimin e gjuhës së tyre. U deshën të bëhen shumë demonstrata dhe ankesa nga ana e turqve para se UNMIK-u dhe OSBE-ja të dakordoheshin që turqishtja të përdorej në regjistrimin e parë të votuesve dhe regjistrimin civil në vitin 2000. Sistemi arsimor ka ngelur ashpërsisht i ndarë, pa asnjë orvatje për të mësuar gjuhët e njëri tjetrit.

Më në fund, të drejtat e dhëna nganjëherë kanë qenë gati se shumë të gjera për të qenë efektive. Këto të drejta janë përpiluar nga ekspertë që nuk u kanë takuar minoriteteve. Për shembull, sipas Kornizës Kushtetuese të gjithëve u akordohet e drejta ‘për të marrë arsim në gjuhën e vet’. Kjo në fakt është e pamundur për t’u implementuar pasi që nuk jep indikim për limitet, pasi që kështu si është përpiluar do të thotë se një minoritet që përbëhet prej një personi do të duhej të ketë të drejtë në arsimim në gjuhën e vet deri në nivelin universitar. Ky përpilim i gjerë i të drejtave d.m.th. se ka qenë e pamundshme që të njëjtat të aplikohen. Këshilli i Evropës ka theksuar se ‘korniza aktuale juridike është tepër komplekse, dhe ajo nuk mund të artikulojë në mënyrë të mjaftueshme dhe të qartë rregullativat operative lidhur me përdorimin e gjuhës’. Në raportin e vitit 2004 të Task Forcës së UNMIK-ut lidhur me Përputhshmërinë e Standardeve të Gjuhës theksoi se ‘Përkundër kërkesave juridike ... përputhshmëria e autoriteteve të Kosovës me standardet gjuhësore është e pamjaftueshme dhe e tejngarkuar me vështirësi të panumërta (disa teknike, të tjerat psikologjike). Ky raport identifikoi dy arsye kryesore: mungesa e resurseve për përkthim, dhe armiqësia e shqiptarëve lidhur me përdorimin e serbo-kroatishtes. Megjithatë, duket se standardet ndërkombëtare si direktivat e Këshillit të Evropës, kanë qenë ato në të cilët është bërë referimi dhe të cilat janë përdorur në politikat për gjuhën. Një propozim ligj për gjuhët është ende duke u diskutuar. Megjithatë, liderët e komunitetit turk e kanë kritikuar propozim ligjin pasi që ai redukton njohjen e gjuhës turke në nivel qendror dhe komunal, në krahasim me ligjin ekzistues (para vitit 1989) dhe Kornizën Kushtetuese.

Statusi i ardhshëm

Pas pastrimit etnik të marsit të vitit 2004 u pranua se duhej zbatuar një qasje e re. Vendimi kryesor ishte fokusimi në statusin e ardhshëm të Kosovës. Marti Ahtisaari, ish Kryetar i Finlandës, u emërua për të udhëhequr me bisedimet për zgjidhjen e statusit dhe për të themeluar një ekip të bazuar në Vjenë. Gjatë shkruarjes së këtij raporti, indikimet janë se statusi i ardhshëm do të jetë pavarësi për Kosovën.

Përfshirja e minoriteteve në këto diskutime, të cilat gati se me siguri do të vendosin për konstituimin e ardhshëm të Kosovës, ka qenë mjaft e limituar. Është fatkeqësi që diskutimet janë duke u mbajtur në Vjenë, gjë që limiton participimin e atyre që janë më së shumti të disavantazuar. Minoritetet më të vogla u konsultuan vetëm një herë, në janar të vitit 2006, por vetëm lidhur me ‘çështje të minoriteteve’. Përfaqësuesit e këtyre minoriteteve kanë kërkuar participim në ekipin kosovar të negociatorëve por janë refuzuar. Edhe një herë, statusi i ardhshëm i Kosovës është duke u vendosur pa participim të minoriteteve. Participimi i minoriteteve dhe të drejtat e minoriteteve nuk gjenden shumë lart në agjendën e atyre që përcaktojnë të ardhmen e Kosovës nga një vend aq i largët.

Në vend të kësaj, në Vjenë ‘çështjet e minoriteteve’ janë fokusuar gati se në mënyrë ekskluzive në serbët dhe në çështjen e ‘decentralizimit’. Decentralizimi shihet se solucion për problemet e minoriteteve. Megjithatë diskutimet duket se po ecin kah krijimi i komunave ‘serbe’, të cilave do t’u jepet sa është e mundur më shumë pushtet lidhur me çështje si që janë arsimi, sistemi arsimor dhe policia, duke rrënjësuar edhe më tepër segregacionin. Në një propozim dokument nga UNOSEK (Zyra e KB-së E të Dërguarit të Posaçëm të Sekretarit Gjeneral për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës) lidhur me decentralizimin, nuk është përmendur asgjë lidhur me masat antidiskriminuese, ose të drejtat e minoriteteve dhe integrimin. Është vështirë të shihet se si një propozim i këtillë mund të çojë kah zgjidhjet e qëndrueshme për Kosovën, veçanërisht pasi që çdo komunë do të ketë minoritetet e veta dhe problemet e veta të të drejtave të minoriteteve. Ata që janë duke punuar në Vjenë, dhe që si që duket nuk janë duke përfshirë ekspertë të të drejtave të minoriteteve, janë duke krijuar një ardhmëri për Kosovën e cila injoron të drejtat e individëve dhe grupeve dhe thëllon segregacionin, bile edhe në fusha si që janë forcat policore ku integrimi ka qenë duke shënuar progres. Nuk është duke u bërë asnjë përpjekje për krijimin e një sistemi të integruar arsimor.

Duke marrë parasysh mungesën e interesit për të drejtat e minoriteteve në UNOSEK, veçanërisht lidhur me të gjitha grupet minoritare përveç serbëve, Delegacioni kosovar i negocuesve ka përpiluar një ‘Kornizë për Mbrojtjen e Komuniteteve në Kosovë’. Çuditërisht, duket se minoritetet edhe njëherë janë duke u përjashtuar nga participimi në përpilimin e tij, ndërsa diskutimet janë zhvilluar në Selanik – pasi që ato që kanë përpiluar dokumente të këtilla duket se besojnë se është shumë e vështirë të diskutohet ardhmëria e Kosovës në vetë Kosovën. Ky dokument, me përafërsisht 60 faqe, është një miks kurioz i një kushtetute të propozuar, ligje të reja, dokumente për të drejtat e minoriteteve dhe propozime për 16 këshilla dhe komisione që duhet të mbrojnë të drejtat e minoriteteve. Kjo Kornizë ripërsërit shumicën e problemeve që e kanë shqetësuar Kosovën që kur komuniteti ndërkombëtar hyri në skenë. Përveç se thekson se të gjithë popujt në Kosovë do të jenë të barabartë, kjo kornizë gjithashtu përshkruan edhe minoritetet më të vogla (d.m.th. jo serbët) si ‘komunitetet të tjera’, duke i degraduar ata qartësisht në status të klasës të dytë. Përveç se thekson se diskriminimi shpallet si joligjor (në fakt i tillë është), kjo Kornizë do të thellojë segregacionin edhe më tepër duke vendosur në ligj

kuota etnike në të gjitha pjesët e shërbimeve publike, përfshirë dhe policinë, dhe nuk do të bëjë adresimin e diskriminimit. Korniza krijon një seri të të drejtave të reja dhe të gjera në letër por, nëse të njëjta vendosen në praktikë, krijimi i të drejtave dhe ligjeve të reja do të minimizojë ligjet ekzistuese, veçanërisht ligjin antidiskriminim. Që situata të jetë edhe më e keqe, me krijimin e një serie të tërë të komisioneve (si komisioni për gjuhë) do të vendoset në rrezik dobësimi i strukturave ekzistuese, veçanërisht nevoja që të drejtat të fuqizohen me sundimin e së drejtës dhe me institucionin tani më ekzistues Ombudspersonin. Përpiluesit duket se nuk janë të vetëdijshëm se ligji antidiskriminim, edhe pse i mirë në letër, nuk është implementuar tani dy vjet pas miratimit. Korniza nuk siguron ndonjë zgjidhje për nevojën kryesore për siguri efektive dhe sistem të përgjegjshëm të drejtësisë. Minoriteteve u ofrohet, në rastin më të mirë, një seri e të drejtave në letër, pa asnjë masë efektive të fuqizimit.

Shkaqet rrënjësore të problemit

Pas shtatë viteve nën qeverisjen e KB-së dhe organizatave ndërkombëtare, dhe sigurisë së garantuar nga NATO-ja, situata e minoriteteve në Kosovë është katastrofale. Autoritetet kanë lejuar zhvillimin dhe thellimin e një shoqërie të segreguar, ndërsa me mijëra minoritete ende ngelin të zhvendosura. Pastrimi etnik ndodhi dy vite më parë.

Situata e minoriteteve në Kosovë mbetet më e keqja në Evropë. Kjo nuk mund thjeshtë të arsyetohet si rezultat e konfliktit. Shoqëri të tjera kanë kaluar nëpër konflikte dhe janë ballafaquar me probleme të vazhdueshme. Në Irlandën Veriore, përkundër marrëveshjes për paqe, është bërë shumë pak për të thyer segregacionin bazuar në fe nëpër qytete. Në Qipro, nuk ka shenja për zgjidhjen e konfliktit 40 vjeçar dhe, në veçanti, për kthimin e të zhvendosurve, restaurimin e pronës dhe njohjen e të drejtave të minoriteteve. Në Turqi, ekzistimi i shumicës së minoriteteve – përfshirë 15 milionë kurdë – ende mohohet zyrtarisht. Një rezultat është mohimi i lirisë së kurdëve për të folur gjuhën e tyre, ndërsa po ashtu ka me mijëra të zhvendosur kurdë dhe sirian të krishterë. Bosnjë dhe Hercegovina, nën mbikëqyrje ndërkombëtare për një dekadë, ka segregacion të ashpër në mes të tre ‘popujve konstituent’ dhe status të klasit të dytë për të gjitha grupet tjera. Por asnjëra prej këtyre situatave nuk është aq e keqe për minoritetet si ajo në Kosovë.

Askund në Evropë nuk ka aq segregacion si në Kosovë, me mijëra persona të zhvendosur dhe nëpër kampe, dhe me qytete dhe fshatra etnikisht të pastra të grumbulluara përreth një province aq të vogël. Askund nuk ka një nivel të atillë të frikës se do të maltretohen ose sulmohen për të gjitha ato minoritete, thjeshtë nga fakti se kush janë ata ose çfarë gjuhe flasin. Askund në Evropë nuk ka një rrezik aq të madh se pastrimi etnik mund të ndodhë sërish në të ardhmen e afërt – ose, duke pasur parasysh vrasjet, rrezik nga gjenocidi.

Shkaqet për këtë dështim të protektoratit ndërkombëtar suhet doemos të shqyrtohen, në mënyrë që të sigurohet se leksionet janë mësuar dhe do të aplikohen edhe në Kosovë edhe në misionet e ardhshme paqeruajtëse.

E para, problemet në Kosovë nuk kanë pasur të bëjnë me resurset. Me miliona euro, dhe me mijëra zyrtarë ndërkombëtarë janë sjellë në Kosovë. Duke pasur parasysh popullatën e Kosovës prej pak më shumë se 2 milionë njerëz, kjo mund të jetë njëra prej shumave më të mëdha të parave të shpenzuara nga komuniteti ndërkombëtar për njeri në botë. Por, duhet thënë se nuk është shpenzuar në mënyrë të mençur. Në të vërtetë, shuma e parave e derdhur në Kosovë mund ta ketë bërë situatën e minoriteteve edhe më të keqe duke lejuar krijimin e sistemeve të paqëndrueshme dhe të segreguara, si për shembull shërbimet e veçanta të shëndetit.

Shkaku rrënjësor i dështimit në Kosovë nuk ka qenë dështimi për të njohur ekzistimin dhe rëndësinë e minoriteteve. Në teori, të gjitha komunitetet në Kosovë janë njohur dhe të gjithave u janë akorduar të drejta. Nuk ka një mohim sistematik të ekzistimit të tyre, si që është rasti në Turqi ose në Francë. Çështjet minoritare është pranuar të jenë shumë të rëndësishme që nga viti 1999. Sasia e informatave të disponueshme për minoritetet, veçanërisht përmes raporteve zyrtare të OSBE-së/UNHCR-së ka qenë ekstensive.

Nuk ka qenë as çështje e mungesës së të drejtave në letër. ‘Komuniteteve’ u janë akorduar të drejta ekstensive sipas Kornizës Kushtetuese. Siç është përshkruar më sipër, është miratuar një ligj i avancuar antidiskriminim. Janë përpiluar udhëzime të detajizuara dhe politika për kthim. ‘Standardet për Kosovën’ duket se kanë adresuar

shumicën e nevojave të minoriteteve. Megjithëse nuk ka një ligj për minoritetet si të tillë, megjithatë në letër ekziston një mbrojtje ekstensive e minoriteteve.

Më poshtë sqarohen arsyet kryesore për problemet e minoriteteve sot.

Një qasje e segregacionit, jo e të drejtave të minoriteteve

Përkundër faktit se të drejtat e minoriteteve promovojnë shoqëri të integruara, dhe përkundër faktit se parandalimi i konflikteve kërkon shoqëri të integruara, komuniteti ndërkombëtar në Kosovë ka rforcuar segregacionin të cilin e lejoi të zhvillohet në vitin 1999. Në fakt, marrja me çështje të minoriteteve duket të ketë qenë vetëm një çështje e adresimit të kërkesës së liderëve serbë për segregacion efektiv. Të gjitha grupet tjera minoritare në mënyrë efektive janë trajtuar si klasë i dytë.

Kjo është e evidente në politikat e miratuara të sigurisë, në sistemin elektoral të bazuar në një përfaqësim të pastër etnik, në qasjen në shërbimet publike të bazuara në arsim të veçantë dhe sisteme të veçanta të shëndetësisë për shqiptarët dhe serbët, dhe në shërbimet tjera të punësimit dhe shërbime tjera ku kuotat shpesh duket të jenë zgjidhjet e vetme të propozuara. Disa përjashtime kanë qenë miratimi i ligjit antidiskriminim (edhe pse implementimi i tij nuk ka qenë ndonjë prioritet) dhe, deri në ndonjë shkallë, themelimi i SHPK, i cili ka adoptuar një qasje integrative, duke pasur policinë me përbërje nga të gjitha komunitetet e cila përdoret gjithkund dhe, deri më tani, kërcënimi nga një forcë policore e segreguar është evituar. Është e qartë se ka pasur një dështim për të njohur të drejtat e minoriteteve dhe, veçanërisht, nevojën që të bëhet adresimi i plotë i çështjeve të diskriminimit. Ideja e një shoqërie të integruar është parë më shumë si një ideal për të ardhmen se sa një domosdoshmëri për një Kosovë paqësore. Ky mentalitet i segregacionit ka vazhduar dhe është bërë edhe më i thelluar, edhe përkundër ligjit antidiskriminim që përligj segregacionin. Diskutimet për statusin e ardhshëm janë fokusuar në plane për 'decentralizimin' që duket se do të jetë një segregacion efektiv në mes të shqiptarëve dhe serbëve. Edhe 'Korniza' për minoritetet reflekton një mentalitet segregacioni. Në të gjitha këto propozime, minoritetet më të vogla janë reduktuar me status të klasës së dytë.

Para së gjithash, politikë afatshkurtër

Duke parë se çfarë ka ndodhur në Kosovë vit pas viti, duke u marrë si prioritet kuptimi i konsiderimeve 'politike' afatshkurtra në kurriz të të drejtave të minoriteteve është i tepërt. Rëndësia më e madhe i është kushtuar statusit të Kosovës. Rezoluta 1244 dhe krijimi i UNMIK-ut dhe KFOR-it, kanë qenë masa të përkohshme që e lanë statusin e ardhshëm të Kosovës si të pasigurt. Efekti i kësaj në minoritetet e Kosovës ka qenë veçanërisht destruktiv. Shqiptarët dhe serbët donin të vendosin kërkesat e tyre në pjesë të Kosovës dhe prandaj nxitja për zona të pastra ka qenë aq e fortë. Nuk kanë qenë të mundura zgjidhje afatgjata, përfshirë edhe për çështje kritike si që është arsimi. Në vend që të negociojnë në Kosovë, serbët kërkuan Beogradin për mbrojtje.

Në të njëjtën kohë, një politikë katastrofike e administratës ndërkombëtare që nga viti 1999 ka pasur për qëllim të akomodojë ata që zhvillojnë pastrim etnik dhe jo që të njëjtët të arrestohen. Pastrimi etnik i zhvilluar nga shqiptarët dhe serbët ka qenë sistematik, duke kërkuar organizim në nivelin më të lartë. Në vitin 1999 KFOR-i kishte 50.000 ushtarë dhe, gjatë kësaj periudhe, administrata ndërkombëtare ka pasur mbështetje nga vendet më të fuqishme të botës. Megjithatë ata duket të kenë hezituar që të tangojnë organizatorët e sulmeve ndaj minoriteteve. Si që është paraqitur më sipër, sulmet ndaj minoriteteve kanë qenë të lidhura me anëtarët e UÇK-së dhe një

grup të serbëve në Mitrovicë. Në vend që të arrestohen, liderët e UÇK-së dhe serbët janë emëruar në qeveri. Mesazhi që është dërguar herë me radhë është se administratorët ndërkombëtarë e kanë pranuar rezultatin e pastrimit etnik dhe sulmet ndaj minoriteteve. Janë arrestuar vetëm shkelësit e imtë.

Në të njëjtën kohë, UNMIK-u dhe KFOR-i kanë lejuar funksionimin e strukturave paralele të masë të madhe të qeverisura nga Beogradi pasi që konfrontimi do të shkaktonte probleme afatshkurtra. Duke pasur arsimin, policinë dhe gjyqësinë e ndarë për serbët, ka qenë e pamundshme promovimi i një shoqërie të integruar (duke lënë anash të drejtat e minoriteteve në zonat e dominuara me serbë).

Një mentalitet tjetër destruktiv por këmbëngulës është 'se nuk është koha e duhur' për të fuqizuar me agresivitet të drejtën në kthim dhe moslejtim të pastrimit etnik. Në fakt, sa më gjatë që lejohet pastrimi etnik të zhvillohet i pa sfiduar, aq më vështirë do të jetë që të bëhet kthimi i njerëzve. Megjithatë, qasja në Kosovë duket të ketë evituar tangimin e çështjes së segregacionit dhe kthimit. Më lartë janë përshkruar shembuj ekstrem, si për shembull roli i KFOR-it gjerman dhe të tjerëve në mos adresimin e të drejtës së popujve për të rimarrë pronën e tyre. Çështja bazike është se, edhe pse të gjithë përfshirë këtu edhe minoritetet, kanë të drejtë në kthim, kjo e drejtë është trajtuar si një privilegj që do të lejohet vetëm kur nuk shkakton probleme.

Mungesa e qeverisë së pastër dhe të përgjegjshme

Një problem tjetër serioz që parandalon zhvillimin e politikave të zëshme dhe afatgjata ka qenë sistemi i qeverisë së vendosur në Kosovë. Si që është përshkruar më sipër, është mjaft komplekse. Që nga fillimi KFOR-i dhe UNMIK-u u themeluan si trupa të veçanta; KFOR-i kishte përgjegjësi për çështjen më kryesore për shumicën e minoriteteve – sigurinë. Por vetë KFOR-i nuk ka qenë një trup i unifikuar, pasi ka pasur njësi dhe brigada individuale që shumë shpesh kanë pasur politikën e veta. Themelimi i IPVQ ishte vetëm një element i tretë i konfuzionit së fotografisë së përgjithshme. Nuk është surprizë që ka pasur një politikë konsistente afatgjate – ose të paktën të kuptueshme – lidhur me sigurinë dhe çështje të tjera të rëndësishme.

Zhvillimi i politikave është afektuar negativisht nga fakti që UNMIK-u dhe KFOR-i nuk janë të përgjegjshme për vendimet e tyre as ndaj elektoratit as, në një mënyrë domethënëse, ndaj medimeve. Qasja e tyre tregohet nga deklaratat e imunitetit të plotë sipas Rezolutës 2000/47 që i privon të gjithë kosovarët nga çfarëdo kërkesë për përgjegjësi ndaj tyre. Si që është potencuar më sipër, minoritetet janë ankuar shpesh e më shpesh për mungesën e konsultimeve me ata lidhur me atë se çfarë është duke u bërë për mbrojtjen e tyre. Kjo i ka lënë ata të ndjehen pa asnjë ndihmë por gjithashtu ka prodhuar politika të këqija. Edhe një herë, zyrtarët ndërkombëtarë kanë mbetur vetëm me konsultime me disa liderë (që nga njëherë kanë qenë të vetëquajtur). E vetmja mënyrë për të mbajtur UNMIK-un të përgjegjshëm për sjelljen e tij ndaj minoriteteve ka qenë përmes Ombudspersonit, dhe madje tani më edhe ky institucion nuk ka pushtetin për ta mbajtur UNMIK-un të përgjegjshëm. Nuk ka pasur asnjë metodë për ta mbajtur KFOR-in përgjegjës.

Është bërë shumë pak për të siguruar dëgjimi i zërit të veçantë të femrave minoritare në vazhdimësi, ose për të bërë vendimmarrësit përgjegjës para tyre.

Mbi të gjitha, UNMIK-u dhe KFOR-i kanë pasur një agjendë përcaktueshmërisht afatshkurtër. Deri më tani ka pasur gjashtë PSSP për shtatë vite, ndërsa stafi ndërkombëtar dhe trupat e KFOR-it kanë qenë në Kosovë, zakonisht, vetëm për një periudhë të shkurtër (KFOR-i ka bërë rotacion të trupave çdo gjashtë muaj), edhe përkundër pushtetit të cilin e kanë ushtruar. Është bërë shumë pak për

ndërtimin e njohurive institucionale. Edhe pse situata nuk është aq e keqe si në Bosnjë, ka pasur një sërë zgjedhjesh (katër për gjashtë vite), duke u fokusuar sërish në çështje afatshkurtra.

Mungesa e një mbrojtjeje reale të të drejtave të njeriut dhe qeverisja e të drejtës

Një problem tjetër fundamental me administratën ndërkombëtare ka qenë mënyra me të cilën janë marginalizuar në masë të madhe të drejtat e njeriut dhe qeverisja e të drejtës, të cilat gati se çdo herë kanë zënë vendin e dytë në konsideratat politike afatshkurtra. Edhe pse misioni i gjerë i OSBE-së zyrtarisht formon pjesë të UNMIK-ut, ka qenë mjaft e vështirë që të arrihet ndryshim i politikave lidhur me të drejtat e njeriut në UNMIK dhe KFOR. Këshilltari i PSSP-së për të Drejta të Njeriut dha dorëheqje vetëm pas gjashtë muajve dhe nuk u bë zëvendësim në vendin e tij. Të drejtat e njeriut janë parë si opcionale.

Edhe më e çuditshme ka qenë mungesa e respektimit për sundimin e të drejtës, e cila gjithashtu është parë si opcionale, veçanërisht në relacion me UNMIK-un dhe KFOR-in, autoritetet qeverisëse. Duhet përmendur edhe një herë Rregullorja 2000/47 e cila ka tentuar t'i bëjë ata imun nga të gjitha format e procedimeve juridike. Ligjet që janë miratuar nuk janë përkthyer shpejt në gjuhën shqipe, e aq më pak në gjuhët e minoriteteve. Madje edhe e drejta më bazike e të drejtës së të drejtave të njeriut, ajo që paraburgimi të bëhet vetëm me një urdhër të gjykatësit, është kthyer mbrapsht nga ana e KFOR-it dhe UNMIK-ut, të cilat kanë deklaruar vetët e tyre mbi ligjin, duke mos dashur të punojnë në përputhshmëri me standardet e të drejtave të njeriut.

Rezultati është se i gjithë përpilimi dhe akordimi i supozuar i të drejtave ka qenë jokuptimplotë pasi që, edhe kur të drejtat janë të proklamuar, nga autoritete nuk kërkohet që të ndër marrin aksion. Vetë Korniza Kushtetuese ka pasur një ndikim minimal. Kapitulli mbi 'Të drejtat e komuniteteve', si që është theksuar edhe më sipër, nuk është përpiluar nga ekspertë për çështje të minoriteteve dhe në shumicën e rasteve është shumë i gjerë dhe i papërdorshëm. Por, për të qenë gjendja edhe më keq, ky dokument nuk është aplikuar si ligj suprem kushtetues. Edhe pse Korniza Kushtetuese ka pasur dispozita lidhur me një Dhomë Kushtetuese e cila do të shqyrtonte dhe do të hidhte poshtë ligje dhe politika që shkelnin Kornizën, në praktikë kjo nuk ka ndodhur asnjëherë.

Në mënyrë të ngjashme, 'Standardet për Kosovën' kanë dështuar që në mënyrë të vërtetë të përmirësojnë situatën e minoriteteve. Standardet në vete janë të mira, dhe takojnë shumë nevoja të minoriteteve. Aty ku ata kanë dështuar është implementimi, i cili në mënyrë efektive ka kërkuar bashkëpunim të plotë dhe të detajizuar (dhe përgjegjshmëri) në mes të IPVQ, UNMIK-ut dhe KFOR-it.

Ndikimi i mungesës së qeverisjes të së drejtës gjithashtu ndihmon në shpjegimin e mungesës së sigurisë. Bombardimi i Nish Ekspresit në vitin 2001 ka qenë njëri nga sulmet më të rënda ndaj minoriteteve. Pas kësaj, u arrestua një i dyshuar, kundër të cilit u prezantuan prova dhe i cili u paraburgos sipas një urdhri të gjyqit në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë. Pastaj KFOR-i amerikan arriti në Qendrën e Paraburgimit (që nuk ka qenë zonë e tyre e përgjegjësisë) dhe e morri atë në qendrën e tyre për paraburgim në kampin Bondsteel. Pastaj ata shpallën që ai ka ikur (ky është personi i parë që ka arritur të ikë nga këtu) dhe nuk u dëgjua më për të, deri sa filluan thashetheme për arrestimin e tij në vitin 2004. katër të tjerë u paraburgosën nga ana e KFOR-it, dy prej tyre ishin pjesëtarë të TMK-së. Megjithatë, KFOR-i refuzoi të paraqesë prova para gjyqit dhe prandaj një gjyqtar (ndërkombëtar) refuzoi që të urdhërojë paraburgimin e tyre. Në vend të tij, PSSP, duke vepruar me

shkelje të urdhrat të gjyqit, urdhëroi paraburgimin e tyre. Kjo ndodhi në një kohë kur UNMIK-u dëshironte që serbët të participojnë në zgjedhje dhe liderët serb kërkonin veprim lidhur me hetimet e bombardimit të Nish Ekspresit. Ky paraburgim pa asnjë urdhër gjyqësor u kritikua shumë nga OSBE-ja dhe të tjerët si shkelje e qeverisjes të së drejtës. Natyra politike e këtij treni të ngjarjeve u bë i dukshëm atëherë kur pas zgjedhjeve, nuk u bë një urdhër tjetër për paraburgim dhe, duke qenë se KFOR-i ende refuzonte të prezantojë prova para gjyqit, të dyshuarit u liruan. Që këtu, askush nuk u përndjek për njërin prej vrasjeve më të rënda kundër serbëve.

Dobësia e shoqërisë civile/dështim për t'u involvuar

Një dobësi tjetër në Kosovë ka qenë dështimi për të involvuar shoqërinë civile dhe, në veçanti, të tejkalohen disa liderë të komuniteteve minoritare. MRG (Grupi Ndërkombëtar i të Drejtave të Minoriteteve) ka përfunduar se në Kosovë ka shumë pak organizata joqeveritare të pavarura të minoriteteve, më pak se kudo tjetër në rajon.

Në mënyrë paradoksale, kjo mund të ketë ndodhur pjesërisht për shkak të sjelljes së një sasive aq të madhe të parave ndërkombëtare në Kosovë. OSBE-ja dhe shumë qeveri ndërkombëtare kanë derdhur një sasi të madhe të parave në atë që ata e quajnë 'përkrahje e shoqërisë civile', por kjo duket që në një masë të madhe të ketë konsistuar në para për mbështetje teknike të OJQ-ve; këto OJQ pastaj u bënë të varura nga bamirësia ndërkombëtare dhe sasi të mëdha të 'trajtimeve'. Individët që punonin në OJQ kanë lëshuar punën për të kaluar në organizata ndërkombëtare ose e kanë lëshuar Kosovën. Ajo që është bërë shumë rrallë është mbështetja e fushatës së vazhdueshme të OJQ-ve të cilat mund të angazhohen me minoritetet dhe të përfaqësojnë ato.

Statusi i Kosovës gjithashtu e ka bërë të vështirë që OJQ-të e pavarura të operojnë. Statusi i pasigurt i Kosovës d.m.th. se vendimet për serbët në masë të madhe janë marrë nga autoritetet në Beograd. Autoritete ndërkombëtare mezi kanë mundur të ndihmojnë në këtë situatë. Duke vendosur zgjedhjet mbi gjithçka tjetër ata e kanë inkurajuar politizimin e tërë jetës. Dhe, duke pasur parasysh vendimmarrjen solide të UNMIK-ut dhe KFOR-it, kjo ka ndodhur pas dyerve të mbyllura, ndërsa 'konsultimet' me komunitetet minoritare në masë të madhe kanë përfshirë liderë meshkuj. Involvimi i një zëri distinktiv të femrave minoritare ka qenë i limituar.

Kjo duket më së shumti, në përpilimin e Kornizës Kushtetuese, e cila është dashur të jetë gurthemel për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve. Megjithatë, ky dokument është përpiluar pas dyerve të mbyllura nga një grup i ekspertëve ndërkombëtarë. Duke pasur parasysh rezultatin, është e vështirë të besohet se cilido prej tyre ka qenë ekspert i të drejtave të minoriteteve. Komunitetet minoritare që janë konsultuar janë përbërë nga disa serbë, të cilët siç duket kanë qenë të zgjedhur nga ana e Beogradit. Në vend të koncentrimit në mbrojtjen e minoriteteve inputi i tyre duket të ketë qenë objekt i çfarëdo që do të përbëhej nga shenjat e pavarësisë së Kosovës. Edhe njëherë, pasiguria lidhur me statusin e Kosovës ka parandaluar që të merren aksione lidhur me faktet aktuale. Korniza Kushtetuese është miratuar thjeshtë nga ana e UNMIK-ut – siç duket presioni për të mbajtur zgjedhje në vitin 2001 ka qenë më i rëndësishëm se sa nevoja për t'u involvuar në konsultime të plota me vetë minoritetet (dhe me kosovarët). Çuditërisht, gabimi i njëjtë është bërë disa herë gjatë diskutimeve për statusin e ardhshëm të Kosovës, i cili është duke u përcaktuar në Vjenë, një vend shumë i largët nga Kosova, dhe pa participim të minoriteteve. Përsëri,

presioni për të gjetur një zgjidhje duket të jetë më i rëndësishëm se sa nevoja për participim dhe për të nxjerr zgjidhjen më të mirë.

Dështimi organizatave ndërkombëtare për të aplikuar mësimet e nxëna jashtë Kosovës dhe për të përdorur memorien e tyre institucionale

Në Kosovë, gabimi kryesor është bërë lidhur me kuptimin dhe aplikimin e të drejtave të minoriteteve. Ajo që është gati se mahnitëse është se këto gabime janë bërë nën administratën ndërkombëtare që përbëhet nga institucione, kryesisht KB dhe OSBE, që kanë një memorije të gjatë institucionale të adresimit të të drejtave të minoriteteve.

OSBE-ja ka qenë e involvuar në Kosovë para Misionit Verifikues në Kosovë (MVK). KLMK i atëhershëm ka qenë 'përfaqësuesi personal' i Presidencës së OSBE-së në Kosovë deri në vitin 1998. Në hyrjen e raportit të OSBE-së *Parë, treguar* në vitin 1999, PSSP i atëhershëm kërkoi nga KLMK që të vjen në Kosovë. KLMK erdhi, por vetëm për një ditë. OSBE-ja në Kosovë vendosi dhe udhëhoqi punën e vet ekstensive për minoritetet me një input minimal nga KLMK-ja. KLMK (Rolf Ekeus) nuk e vizitoi Kosovën deri në vitin 2005. mentaliteti ka qenë se çdo mision i OSBE-së do të vendosej dhe udhëhiqej vetë me një koordinim dhe input minimal nga qendra e OSBE-së. Çuditërisht, KLMK nuk është parë si institucion vital për përcaktimin e politikave në Kosovë.

Situata ka qenë edhe më e keqe me trupat e KB-së. Kosova është njëra nga misionet më të mëdha që ka pasur ndonjëherë KB-ja dhe është supozuar se KB-të kanë një rol të madh qeveritar. Minoritetet kanë qenë në zemrën e ardhmërisë afatgjatë. Megjithatë duket se UNMIK-u as që filloi të komunikojë me ekspertët e KB-së për minoritetet në Gjenevë deri së voni. Grupi Punues i KB-së për Minoritetet nuk është ftuar për të vizituar dhe kontribuar në politikat për minoritetet. Edhe nga Eksperti i ri i Pavarur i KB-së për Çështje të Minoriteteve nuk është kërkuar të luajë ndonjë rol. Përsëri, politikat për minoritetet janë përpiluar në Prishtinë, duke injoruar njohuritë institucionale të KB-së.

Për të kuptuar këtë duhet të kuptohet struktura e KB-së. UNMIK-u u themelua dhe është përgjegjës para Këshillit të Sigurisë; në fakt udhëhiqet nga Departamenti për Operacione Paqeruajtëse, i cili si Këshilli i Sigurisë, është i bazuar në Nju Jork. Puna për të drejtat e njeriut në KB në masë të madhe qeveriset nga OHCHR i locuar në Gjenevë. Si që është theksuar më sipër, të drejtat e minoriteteve në përgjithësi kanë qenë të minimizuara brenda për brenda UNMIK-ut – duket se OHCHR nuk është konsultuar lidhur me krijimin e UNMIK-ut. Madje edhe brenda vetë OHCHR-së çështjet e minoriteteve janë të minimizuara; deri në krijimin e Ekspertit të Pavarur për Çështje të Minoriteteve në vitin 2005 ka pasur vetëm një ekspert të minoriteteve në këtë zyrë (tani ka tre). Kuptimi për të drejtat e minoriteteve në KB në Nju Jork virtualisht nuk ekziston – MRG asnjëherë nuk ka takuar një ekspert të të drejtave të njeriut të punojë atje. Kjo mungesë e njohurisë për të drejtat e minoriteteve është e vështirë të kuptohet duke pasur parasysh rëndësinë e çështjeve minoritare për parandalimin e konfliktit. Mungesa e ekspertizës institucionale në KB është prezantuar në mënyrë të dhimbshme nga gabimet e përsëritura në Kosovë.

Ajo që ka ndodhur është se ata që kanë punuar në çështje të minoriteteve në Kosovë nuk kanë qenë të aftë të përfitojnë nga dekadat e eksperiencës që vetë organizatat kanë për kuptimin dhe implementimin e të drejtave të minoriteteve. Atëherë nuk është surprizë që është përdorur modeli më i dukshëm – ai i segregacionit – dhe nuk është përdorur ai i të drejtave të minoriteteve.

Konkluzion

Në vitin 1999, Berndar Kouchner, PSSP i atëhershëm shkroi:

‘Nëse triumfon mëria etnike, atëherë gjithçka për të cilën njerëzit me vullnet të mirë [në Kosovë] dhe shokët e tyre në komunitetin ndërkombëtar kanë luftuar gjatë viteve të kaluara do të kishte qenë e pashpresë.’

Situata e minoriteteve sot në Kosovë është më e keqja në Evropë. Autoritetet nuk kanë qenë të afta që të sigurojnë mbrojtjen më kryesore, atë të minoriteteve, që ata të kenë mundësi të jetojnë dhe praktikojnë mënyrën e tyre të jetës në siguri. Pas shtatë viteve, minoritetet ende janë të zhvendosur, në pamundësi që të jetojnë në shtëpitë e tyre. Kosova është një shoqëri e segreguar pa vizion për integrim ose plan të qartë për përfundimin e diskriminimit. Minoritetet në masë të madhe mbesin të pafuqishëm për të afektuar vendimet që kanë rëndësi.

Negociatat e statusit të ardhshëm përfaqësojnë shpresën më të mirë dhe rrezikun më të madh. Mësimet e marra nga këto shtatë vite argumentojnë fuqishëm një qasje të ndryshme që do të çojë kah përfundimi i segregacionit në Kosovë, sesa ndonjë marrëveshje tjetër në sekret. Negociatat për statusin e ardhshëm duhet të çojnë kah një thyerje me segregacionin e kohëve të fundit në Kosovë, dhe të garantojë barazi të vërtetë për të gjithë, dhe të drejtën për të jetuar të lirë dhe që të praktikojnë gjuhën, fenë dhe kulturën e tyre. Nëse nuk bëhet një ndryshim radikal tani, historia e protektoratit ndërkombëtar do të bëhet një dështim i madh i aftësisë së komunitetit ndërkombëtar, dhe veçanërisht të KB-së, për të menaxhuar me situata postkonfliktuale dhe të krijojë një zgjidhje afatgjatë për problemet etnike.

Rekomandime

Në Kosovë

Për të gjithë ata që janë të involvuar në diskutimet për statusin e ardhshëm, përfshirë UNOSEK, qeverinë kosovare dhe Grupin e Kontaktit:

Negociatat për statusin e ardhshëm

- Të gjithë të involvuarit në diskutime, në veçanti UNOSEK, duhet të prioritetizojë kuptimin dhe thellimin e të drejtave të minoriteteve për të gjitha komunitetet në Kosovë. UNOSEK duhet të bëjë një deklaram publik dhe të theksojë rëndësinë e të drejtave të minoriteteve.
- Bisedimet duhet të kenë përfshirje të plotë të të gjitha grupeve në Kosovë, veçanërisht grupeve të vogla të minoriteteve, dhe femrat minoritare, gjithashtu. Pakicat duhet të marrin pjesë në të gjitha çështjet e bisedimeve, jo vetëm ato që prekin “çështjet e pakicave”. Ata që janë të përfshirë në negociatë duhet ti vizitojnë dhe të konsultohen me komunitetet e pakicave rregullisht.
- Gjatë rrjedhës së vitit, bisedimet duhet të zhvendosen nga Vjena në Kosovë të siguroj përfshirje të plotë të kosovarëve, sidomos minoriteteve.
- Ata që janë të përfshirë në bisedime duhet t’i përdorin të gjitha njohurit në dispozicion në lidhje me të drejtat ndërkombëtare të pakicave, sidomos ato të OKB-së (p.sh. Ekspert i pavarur për Çështje të Pakicave dhe Grup Punues për Pakica) dhe Komisionari i Lartë i OSBE duhet të caktoj ekspert për të drejtat e minoriteteve.
- Duhet të qartësohet se qëllimi i negociatave është një zgjidhje e mirë e cila siguron mbrojtje të plotë të të drejtave për të gjithë kosovarët. Asnjë afat i fundit artificial nuk duhet imponuar për ta futurë këtë në rrezik.

Statusi i ri dhe Kushtetuta e Kosovës

- Nëse rezultat i negociatave është pavarësia e Kosovës (çka edhe pritet) ose ndonjë formë e autonomisë së zgjeruar, do të duhej një Kushtetutë e re. Kjo kushtetutë duhet t’i përmbahet disa parimeve për të drejtat e pakicave:
- duhet të paraqes garanci për të drejtat e përcaktuara, mbi format tjera kushtetuese dhe të jenë të gjëra dhe të thjeshta (më mirë se sa norma të detaizuara që janë vështirë për tu zbatuar). Masa speciale, siç janë kuotat, nuk duhet të rregullohen me kushtetutë, sepse do të vështirësonte rregullimin e mëvonshëm të tyre.
- Këto norma duhet të përfshijnë, është e preferuar në nenet e para, garanci për barazi, në teori dhe në përmbajtje, për të gjithë qytetarët dhe të gjithë komunitetet në Kosovë dhe angazhim për një Kosovë të integruar për të gjithë. Drejtat e secilit të zgjedh identitetin e tij, dhe të përdor gjuhën, religjionin dhe kulturën e tyre gjithkund në Kosovë, pa u shkaktuar vuajtje dhe dëmtime.
- Kushtetuta duhet të përcaktoj, si çdo ligj anti-diskriminues, se segregacioni paraqet diskriminim.
- Kushtetuta duhet t’i njoh të gjithë komunitetet si të barabarta në Kosovë. Nuk duhet të ketë tretman superior ndaj një komuniteti (p.sh. shqiptarët apo serbët). Termet që përfshijnë status shkallës së dytë, siç janë ‘Të tjerët’ ose ‘Pakicat jo-serbe’ nuk guxojnë të përdoren.

- Kushtetuta duhet të përcaktoj se shërbimet publike duhet të jenë të integruara, përfshirë arsimin, por me detyrë të merren parasysh të gjitha nevojat e të gjithë komuniteteve në Kosovë, veçanërisht në lidhje me gjuhët, religjionin dhe kulturën e caktuar.
- Kushtetuta duhet të qartësoj se mënyra më e rëndësishme për implementimin e të drejtave është në bazë të ligjit, dhe kështu do të krijohet një sistem i fuqishëm dhe i pavarur me të gjithë autorizimet ndaj sundimit të së drejtës.
- Kushtetuta nuk duhet t'i imponohet Kosovës. Çdo draft që del nga negociatat duhet të përkthehet në të gjitha gjuhët në Kosovë dhe të jetë çështje ekstensive e raundeve këshilluese dhe komenteve, përfshirë seancat publike në të gjithë komunitetet. Drafti duhet të rishikohen pas konsultimeve publike.

Mbarim i segregacionit dhe diskriminimit

- Të gjithë partitë në Kosovë duhet të angazhohen, si prioritet, për mbarimin e segregacionit dhe diskriminimit dhe të sigurojnë integrimin. Pikënisja duhet të jetë zbatimi i ligjit anti-diskriminues. Gjykatësit, avokatët dhe personat tjerë zyrtar duhet të trajnohen për këtë. Kampanja për ngritjen e vetëdijes publike duhet të filloj sa më shpejt që është e mundshme.
- Decentralizimi duhet të shikohet si mënyra kryesore për mbrojtjen e të drejtave të pakicave, dhe nuk duhet të çoj në segregacion. Të drejtat e të gjithë njerëzve dhe të gjithë komuniteteve në Kosovë të ushtrojnë dhe përdorin gjuhën e tyre duhet të mbrohen nga çdo komunë.
- Decentralizimi duhet të jetë legalisht i nënshtuar ndaj kushtetutës dhe ndalimeve ligjore ndaj diskriminimit dhe segregacionit.
- Komunat artificialisht të dizajnuara, me qëllim të krijimit të shumicës etnike lokale, duhet të shmangen.
- Duhet të jetë një sistem policor dhe gjyqësor i integruar si dhe shërbimet publike. Decentralizimi nuk guxon të shpie de facto deri te segregacioni i tyre. Diskriminimi në shërbimet publike, veçanërisht ideja se komunitetit duhet t'i shërbej anëtarit i komunitetit të tyre, fuqishëm duhet të ndalohej.
- Sistemi i arsimit publik në Kosovë, përfshirë shkollat dhe institucionet e larta arsimore, duhet të jenë plotësisht të integruara. Nuk duhet të ketë shkolla 'etnike' ose universitete. Rregullat për arsimin në të gjitha gjuhët e Kosovë duhet të jenë të garantuara me ligj dhe në praktikë. Të gjitha gjuhët, religjionet dhe kulturat duhet të përdoren. Duhet të përdoret një plan mësimor i përbashkët për të gjithë Kosovën, posaçërisht në lëndën e historisë, në gjuhë të ndryshme ku e njëjta kërkohet.

Garantimi i sigurisë dhe ndalimi i pastrimit etnik

- Bisedimet e plota dhe publike duhet të kryhen nga OKB-ja sepse sigurimi i mbrojtjes së minoriteteve ka qenë i dobët dhe çka duhet të bëhet në të ardhmen që tu jepet komuniteteve të pakicave ndjenjën e sigurisë dhe dëshirës për tu kthyer në shtëpitë e tyre. Komunitetet e pakicave duhet të konsultohen për këtë, sidomos gratë.

- Kushtetuta duhet të kërkoj të gjitha sektorët qeveritare, sidomos policia dhe gjyqësia, t'i japin përparësi mbrojtjes së minoriteteve.
- Duhet patjetër të ekzistojnë garancionet për pavarësinë e sektorit gjyqësor dhe mbrojtje nga përzierjet politike. Prokurorët, të cilët janë kompetent për ndjekjet penale, duhet tu kërkohej me ligj që të hetojnë sidomos krimet me baza etnike dhe t'i ndjekin liderët dhe organizatorët e tyre.
- Përkujdesje të veçantë dhe vigjilencë duhet të ndërmerret me qëllim të sigurimit të integritetit të sistemit juridik dhe policisë. Çdo deklaratë diskriminuese ndaj cilido anëtarë duhet shpejt dhe efektivisht të hetohet.
- Nëse Kosova bëhet e pavarur duhet të theksohet se ndihma në të ardhmen dhe integrimi në strukturat evropiane do të varet prej garantimit të të drejtave të pakicave në Kosovë, dhe të sigurojnë se zhvendosja është zgjidhje e lirë, si dhe kthimi.

Sundimi i së drejtës

- Duhet të jetë një angazhim i qartë që siguron sundimin e së drejtës në Kosovë, posaçërisht në lidhje me implementimin e të drejtave. Gjykatat dhe sistemi i së drejtës duhet të shihen si mbrojtës primarë të së drejtave, përfshirë të drejtat e pakicave.
- Të gjitha partitë duhet të angazhohen për të siguruar se ekziston sistem juridik i pavarur dhe efektiv, i cili mund nuk përjashton as autoritetet qeveritare.
- Për pakicat do të jetë posaçërisht e rëndësishme të sigurojnë se sistemi juridiko-penal, ligji anti-diskriminues dhe ligjet mbi pronën implementohen. Pakicave duhej asistuar në sjelljen e test rasteve nën ligjin anti-diskriminues.

Angazhimi ndërkombëtar në Kosovë

- UNMIK-u, dhe të tjerët pasardhës, duhet t'i japin prioritet këtyre gjërave: -sigurimin e një niveli më të lartë të sigurisë-dhe perceptimin për sigurinë e pakicave, veçanërisht hetimin dhe ndjekjen e udhëheqësve të sulmeve ndaj pakicave, si ato në mars të 2004;
- -implementimin e ligjit anti-diskriminues dhe sigurimin se shërbimet publike janë të integruara, sidomos arsimit

Misionet paqeruajtëse për të ardhmen

- Mungesa e të kuptuarit të të drejtave të pakicave në Kosovë asnjëherë nuk duhet përsëritur posaçërisht kur ca konflikte ndodhin për çështje të pakicave (etniciteti, gjuha dhe religjioni).
- Departamenti i Operacioneve Paqeruajtëse i OKB-së (DPKO) duhet të caktoj ekspert për çështje të pakicave të këshilloj në çështjet e pakicave dhe udhëheqjen me politikat të misioneve të tanishme dhe të ardhshme paqeruajtëse.
- OKB-ja në tërësi (Ekspert i pavarur, Grupi punues dhe ekspertët tjerë në New York) duhet të hartojnë udhëheqje për politikat themelore për të drejtat e pakicave në situatat para dhe pas konfliktuozë. Ato duhet të mbështeten në njohurit për të kaluarën, posaçërisht nga Kosova, dhe të theksojnë implementimin e standardeve të OKB-së, përfshirë UNDM, rëndësinë e të drejtave për të gjitha grupet e pakicave, jo vetëm për disa; ndalimin e diskriminimit përmes ligjeve dhe politikave dhe jo promovimit të segregacionit; garantimin e të drejtës së përcaktimit të identitetit.

- DPKO, duke punuar me shtetet anëtare që kujdesen për ruajtjen e paqes, duhet të promovojnë dhe të zhvillojnë të kuptuarit se pastrimet etnike duhet të ndërpriten shumë shpejt pas konflikteve, duke lejuar refugjatëve të kthehen. Situata si ajo me Kosovën, ku paqeruajtësit vazhdimisht kanë theksuar 'nuk është koha e duhur' për t'u kthyer, nuk duhet të paraqitem më.
- Zyra e OKB-së e Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut duhet të rris dukshëm trajnimet në lidhje me të drejtat e pakicave të stafit të saj dhe stafit tjetër të OKB-së në regjionet konfliktuoze. Stafi i OHCHR në çdo zyrë ku ka pasur ose ka gjasa se mund të ndodhin konflikte etnike ose religjioze duhet të ketë ekspert për të drejtat e minoriteteve.
- Zyra e Komisarit të Lartë të OSBE-së për Pakicat Kombëtare duhet të ketë një rol koordinues për të gjithë punën e bërë nga OSBE-ja për çështjet e pakicave. Zyra duhet të caktoj mbledhje të rregullta në Hagë dhe gjithkrah për të gjithë stafin punues të OSBE-së të angazhuar për çështjet e minoriteteve (i, e cila duhet të jetë ekspert/e) për të ndarë përvojën.

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, 16 Dhjetor 1966

Neni 27

Në ato shtete ku ekzistojnë pakicat etnike, religjioze ose linguistike, personi që i takon pakicave të tilla nuk duhet mohuar e drejta, në bashkësi ose me anëtarët e tjerë të grupit, të gëzojnë kulturën e tyre, të ushtrojnë religjionin e tij, ose të përdorin gjuhën e tyre. Deklarata e OKB-së për të drejtat e personave që i takojnë pakicave kombëtare ose etnike, religjioze ose linguistike .

Neni2

....

2. Personat që u takojnë minoriteteve duhet të kenë të drejtë të participojnë efektivisht në jetën kulturore, religjioze, shoqërore, ekonomike dhe publike.
3. Personat që u takojnë pakicave duhet të kenë të drejtë efektivisht të participojnë në vendimmarrjen kombëtare dhe, kur duhet, në nivel regjional kur ka të bëjë me regjionin ku pakicat jetojnë, në përputhje dhe jo në kundërshtim me legjislacionin kombëtar.

Neni 9

Agjencitë e specializuara dhe organizatat tjera të OKB-së duhet të kontribuojnë në realizimin e plotë të të drejtave dhe principeve të përcaktuara me Deklaratë, në kuadër të kompetencave të tyre.

Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (1995)

Neni 3

1. Secili person, i cili i takon pakicave kombëtare duhet të ketë të drejtën lirisht të zgjedh të trajtohet ose mos të trajtohet si i tillë (si pakicë) dhe nuk duhet të rezultojë asnjë disavantazh nga zgjedhja e tij ose nga ushtrimi i të drejtave që janë të lidhur me këtë zgjidhje

Neni 6

.....

2. Partitë duhet të ndërmarrin masa të duhura të mbrojnë personat të cilat mund të jenë subjekt I kërcënimeve ose akteve diskriminuese, keqtrajtjimeve ose dhunës si rezultat I identitetit të tyre etnik, kulturor, linguistik ose religjioz.

Neni 15

Partitë duhet të krijojnë kushtet e nevojshme për participim efektiv të personave që I takojnë pakicave kombëtare në jetën kulturore, shoqërore dhe ekonomike dhe punët publike, në veçanti ato që I tangojnë ata.

Shënime

1. Fjalimi i Klubit ekonomik {ikago, 22 Prill 1999
2. Shih www.nato.int/kfor
3. Administratat e mëparshme të KB-së në Kamboxhia, Timorin Lindor dhe Papau të perëndimit kanë qenë më të shkurtër në kohëzgjatje.
4. Shih, për shembull, Zyrën e statistikave në Kosovë 2000 http://www.ks-gov.net/esk/index_english.htm
5. Fillimisht e njohur si mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve.
6. Shih Malkom, N., Kosovo: Historia e shkurt, Londër, Makmillan 1998, k.15
7. Kjo është e njohur si Misioni Verifikues i Kosovës (KVM)
8. OSBE, Kosovo/Kosova, Si parë, ashtu thënë, Pjesa 1, Varshavë , 1999, http://www.osce.org/documents/mik/1999/11/1620_en.pdf
9. OSCE/UNHCR Vlerësim i tetë i situatës së minoriteteve etnike në Kosovë, Prishtinë, OSBE/UNHCR, 2001 p.1
10. Zubin Potok; Zvecan/Zveçan; Leposavic/Leposaviq
11. Besohet tash në përgjithësi se romët origjinën e kanë vendit që tani njihet si Pakistan ose India veriperëndimore. Shih Malkom, *op.cit.*, ch
12. Ibid
13. Shih ERRC, Drejtësi për Kosovën <http://www.errc.org/cikk.php?cikk=2457&archiv=1>
14. Fjala angleze ‘gypsy’ besohet se rrjedh prej besimit se Romët e kanë origjinën prej Egjypti
15. OSBE/UNHCR vlerësimi i tetë *op. cit.*, p. 34.
16. *Ibid.*, p. 42.
17. Një ndryshim i madh është se gjuha boshnjake e përdor dorëshkrimin latin, ndryshe nga serbishtja që shkruhet në cirilikë
18. OSBE/UNHCR, Vlerësim i situatës së minoriteteve etnike në Kosovë, Prishtinë, OSBE/UNHCR 2000
19. Raporti hije, KMK në Kosovë, Prishtinë, 2005, f. 29
20. Shumë shqiptarë kanë shkuar në Turqi
21. Malcolm, *op. cit.*, ch. 11.
22. Rezoluta 1244 (Këshilli i Sigurimit të KB, 10 Qershor 1999) bile referohet në “numrin e dakorduar” të militantëve Jugosllav dhe serb si dhe personeli policor të kthyer në Kosovë. Nuk ka pasur përpjekje të ndodh kjo.
23. Rezoluta 1244, neni 11
24. Domethënë: Sergio Vieira de Mello (kryes i detyrës), Bernard Kouchner, Hans Haekkerup, Michael Steiner, Harri Holkeri, Soren Jessen-Petersen.
25. KFOR tash është i ndarë në dy brigada
26. Rezoluta 1244, neni 10
27. Shih për shembull konventën ndërkombëtare për të drejtat qytetare dhe politike, neni 17, konventat për të drejtat e fëmijëve, neni 12 dhe konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor.
28. OSBE/UNHCR, Vlerësim paraprak i situatës të minoriteteve etnike në Kosovë, Prishtinë, OSBE/UNHCR
29. OSBE/UNHCR, Vlerësim i situatës të minoriteteve etnike në Kosovë (vlerësimi i dytë), Prishtinë, OSBE/UNHCR
30. Shih OSBE/UNHCR, Vlerësim i situatës të minoriteteve etnike në Kosovë (vlerësimi i nëntë), Prishtinë OSCE/UNHCR

31. OSBE/UNHCR, Vlerësim i situatës të minoriteteve etnike në Kosovë (vlerësimi i tretë), Prishtinë OSCE/UNHCR 1999
32. Informata personale
33. Shih OSBE *As Seen, As Told*, pjesa 1, *op. cit.*, ch. 14.
34. Cituar në *ibid.*, pjesa 2, p. xvi.
35. *Ibid.*
36. *Ibid.*, pjesa 2, parathënie
37. *Ibid.* f.68 cituar UNHCR dhe qendra për paqë dhe tolerancë
38. Shiko OSCE/UNHCR, Vlerësimin e katërt *op. cit.*, f. 18.
39. Më 1999 dokumentet nuk bëjnë dallime në mes romëve, ashaklinjve dhe egjyptasve
40. ERRC, Komentet e shkruara lidhur me Kosovën për KB komiteti për të drejtat e njeriut, Budapest ERRC,2006
41. OSBE , *As Seen, As Told*, pjesa 2, *op. cit.*, p. 43.
42. ERRC Viktimat e helmimit në Kosovë paraqesin fletëparaqitje penale në Gjykatën Evropiane të drejtave të njeriut shkurt 2006 <http://www.errc.org/cikk.php?cikk=2519>
43. OSBE/UNHCR, Vlerësim i dytë, *op. cit.*, p. 1
44. Për përmbledhje të pastrimit etnik shiko Petrovic , D ., pastrimi etnik-orvatje në metodologji *European Journal of International Law*, vol. 5, no. 1,
45. OSBE/UNHCR, Vlerësim i dytë, *op. cit.*, parathënie
46. *Ibid.*, Përmbledhje ekzekutive.
47. Shiko Vëzhguesin “Zbuloj: KB-njësia, mbretëria e terrorit 12 Mars 2000 citat i një raporti të brendshëm të UNMIK-ut. Udhëheqësi i KPC,Agim Ceku ka qenë në daljen masovike të pjesëtarëve të KPC kur gjuha serbe është përdorur në një funksion zyrtar. Ai është emëruar si Kryeministër i Kosovës në vitin 2006.
48. Intervistë me zyrtarë ndërkombëtar 2005 shiko edhe OSBE/UNHCR, vlerësimin e nëntë
49. OSBE/UNHCR, Vlerësim i dhjetë, *op. cit.*, p. 1 Vlerësim i situatës të minoriteteve etnike në Kosovë OSCE/UNHCR, 2002
50. Fjalim në Forumin në Stokholm 28 janar 2004
51. Raport i Sekretarit të Përgjithshëm të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, S/2004/348, 30 prill 2004.
52. Shih, Human Rights Watch (HRË), *Dështimi për të mbrojtur: dhuna kundër minoriteteve në Kosovë, Nju Jork, HRË, 2004.*
53. Intervistë me zyrtarë ndërkombëtarë, Prishtinë, 2005.
54. Shih OSCE, ‘Përgjigja e sistemit të drejtësisë ndaj protestave të marsit 2004’ Prishtinë, dhjetor. 2005; Human Rights Watch (HRË), *Jashtë agjendës: dështimi i vazhdueshëm për adresimin e përgjegjësisë në Kosovën e pas marsit të vitit 2004, Nju Jork, HRË, maj 2005.*
55. KKMK, Neni 6.
56. Shih në veçanti dhjetë vlerësimet e OSCE/UNHCR për situatën e minoriteteve etnike në Kosovë.
57. Me përjashtim të pjesës së policisë franceze dhe italiane të bashkangjitura me armatat e tyre.
58. Njëri prej autobusëve, që transportonte serbë u atakua në shkurt të vitit 2000.
59. OSCE/UNHCR, *Vlerësim i Situatës së Minoriteteve Etnike në Kosovë (Vlerësimi i gjashtë)*, Prishtinë, OSCE/UNHCR, 2000, fq. 27.
60. Shih, për shembull, Grupi Ndërkombëtar i Krizave, *Gjetja e balansit: Shkalla e drejtësisë në Kosovë, Bruksel, GNK, 2002.*

61. Shih Hehir, A., 'Kosova pas pesë viteve', *ZMag*, vol. 17, no. 6, qershor 2004, <http://zmagsite.zmag.org/Jun2004/hehir0604.html>
62. OSCE, *Si e parë, ashtu e thënë*, Pjesa 2, *op. cit.*, p. 72.
63. *Ibid.*, p. 95.
64. Shih OSCE/UNCHR, Vlerësimi i katërt, fq. 16, *op. cit.*
65. OSCE, *Si e parë, ashtu e thënë*, Pjesa 2, *op. cit.*, fq. 101.
66. *Ibid.*, p. 120.
67. OSCE/UNHCR, *Vlerësimi i Situatës së Minoriteteve Etnike në Kosovë (Vlerësimi i pestë)* Prishtinë, OSCE/UNHCR, 2000, p. 2.
68. OSCE/UNHCR, *Vlerësimi i tetë*, *op. cit.*, p. 13.
69. Shih ERRC, *Komente të shkruara lidhur me Kosovën*, *op. cit.*
70. Shih Fabian, G., 'Implementimi i ligjit antidiskriminim në Kosovë; një plan që duhet ekzekutuar' <http://www.errc.org/cikk.php?cikk=2459>
71. Shih OSCE/UNHCR, *Vlerësimi i pestë*, *op. cit.*
72. UE ka vite të tëra përvojë lidhur me ligjin antidiskriminim bazuar në gjini. Dy direktiva të miratuara në vitin 2001 kanë kërkuar që të gjitha vendet anëtare (dhe vendet aplikuese) të miratojnë ligje që ndalojnë diskriminimin bazuar në racë, fe, paaftësi, moshë dhe orientim seksual.
73. Arsyeja kryesore për këtë kundërshtim duket të jetë dëshira për të kundërshtuar krijimin e të gjitha institucioneve permanente të Kosovës.
74. Shih Fabian, *op. cit.*
75. UNMIK, *Plani për Implementimin e Standardeve për Kosovën*, Prishtinë, UNMIK, mars 2004, fq 85.
76. Shih OSCE/UNHCR, Vlerësimi i gjashtë, *op. cit.*, p. 31.
77. OSCE/UNCHR, *Vlerësimi i tetë*, *op. cit.*, p. 14.
78. UNMIK, Rregullore për regjistrimin e kontratave për shitje të pasurisë së patundshme në zona specifike gjeografike të Kosovës, gusht 2001.
79. OSCE/UNCHR, *Vlerësimi i nëntë*, *op. cit.*, p. 38.
80. KMK, Article 15.
81. OSCE/UNHCR, *Vlerësimi i dhjetë*, *op. cit.*, p. 61.
82. *Ibid.*, p. 62.
83. *Ibid.*, p. 60.
84. Korniza Konsultative, ch. 8 (a), <http://www.unmikonline.org/constframeëork.htm>
85. Komiteti Këshillëdhënës për KMK, opinion për implementimin e KMK në Kosovë (miratuar më 25 nëntor 2005), ACFC/OP/I(2005)004, para. 17.
86. Rregullorja No. 2000/47, për statusin, privilegjet dhe imunitetet e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë.
87. Raport nën Hije, *op. cit.*, p. 13
88. *Ibid.*, p.16.
89. UNMIK, Plani Kosovar për Implementimin e Standardeve, *op. cit.*, p. 3.
90. Shih, për shembull, OSCE/UNHCR, Vlerësimi i katërt, *op. cit.*, fq. 5, largimi i gardëve statik pa konsultim.
91. Raport i Sekretarit Gjeneral të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, 26 janar 2004.
92. UNIFEM, 'Profili gjinor, Kosova, <http://www.ëomenëarpeace.org/kosovo/kosovo.htm>
93. Shih 'Rekomandimet e Oslos lidhur me të drejtat gjuhësore të minoriteteve kombëtare dhe notë shpjeguese', http://osce.org/documents/hcnm/1998/02/2699_en.pdf

94. OSCE/UNHCR, Vlerësimi I pestë, *op. cit.*, p. 15.
95. Komiteti Këshillëdhënës I FCNM-së, opinion, *op.cit.* parag. 73.
96. UNMIK, Konkluzat dhe rekomandime të Task Forcës për Përshtatshmërinë gjuhësore, 2004.
97. Fleta për Iniciativë Përkrahëse, Prishtinë, shkurt 2006.
98. Shih Waringo, T., 'Kosova: Mungesa', Transitions Online, maj 2006; URL: <http://www.tol.cz/look/TOL/article.tpl?IdLanguage=1&IdPublication=4&NrIssue=167&NrSection=2&NrArticle=17178>
99. UNOSEK, dokument intern për decentralizimin, prill 2006.
100. Delegacioni Negocues i Kosovës, Korniza për Mbrojtjen e të Drejtave të Komuniteteve në Kosovë, prill 2006.
101. Intervistë me zyrtarë të KB-së, qershor 2006.
102. Vetëm armenët, evrejt dhe grekët njihen si minoritet.
103. OSBE, Si e parë, ashtu e thënë, Pjesa 2, *op.cit.*, Parathënie.

Involvimi

MRG mbështetet në një përkrahje bujare të institucioneve dhe individëve për të përparuar punën tonë. Të gjitha donacionet e pranuar kontribuojnë në mënyrë direkte në projektet tona me minoritetet dhe popujt vendas.

Një mënyrë e vlefshme për të përkrahur këtë është subskrimi në seritë e raporteve tona. Këto persona pranojnë raportet e rregullta të MRG-së dhe shqyrtimin tonë vjetor. Në gjithashtu kemi mbi 100 tituj që mund të blihen nga katalogu ynë i publikimeve dhe web faqja. Përveç kësaj, publikimet e MRG-së janë të disponueshme përmes shemës sonë bibliotekare. Publikimet unike të MRG-së sigurojnë informata mirë të hulumtuara, të sakta dhe të paanshme për të drejtat e minoriteteve dhe popujve vendas nëpër botë. Ne ofrojmë analiza kritike dhe perspektiva të reja për çështje ndërkombëtare. Materialet tona trajnuese të specializuara përfshijnë udhëzime esenciale për OJQ-të dhe instrumente të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhe për qasjen në trupat ndërkombëtarë. Shumë publikime të MRG-së janë përkthyer në shumë gjuhë.

Nëse dëshironi të dini më shumë për MRG, se si të na përkrahni neve dhe se si të punoni me ne, ju lutemi vizitoni web faqen tonë www.minorityrights.org, ose kontaktoni zyrën tonë në Londër.

Të drejtat e minoriteteve nën qeverisjen ndërkombëtare

Minority Rights Group International 54 Commercial Street, London E1 6LT, United Kingdom ISBN 1 904584 46 2

Tel +44 (0)20 7422 4200 Fax +44 (0)20 7422 4201

Email minority.rights@mrgmail.org Website www.minorityrights.org

Pas shtatë viteve të administrimit ndërkombëtar – administrimi më i gjatë dhe më i shtrenjtë që nga krijimi i KB-së – Kosova mbetet njëra nga vendet më të segreguara në Evropë, me mijëra të zhvendosur nëpër kampe, dhe shume qytete dhe fshatra ‘etnikisht’ të pastra.

Raporti diskuton për dështimin e pjesës së protektoratit ndërkombëtar për të mësuar leksione nga e kaluara dhe për të vendosur ekspertizën e të drejtave të minoriteteve që ekziston brenda KB-së dhe trupave të tjera. Ky raport tregon se si vendimmarrësit kanë qenë të papërgjegjshëm, dhe se si i trajton të drejtat e minoriteteve Korniza Kushtetuese të cilën e kanë përpiluar ata, në një mënyrë që inkurajon segregacionin në vend të integritimit.

Në kohën kur diskutohet statusi i ardhshëm i Kosovës, raporti thërret për ndryshime radikale larg nga pranimi i tipareve të segregacionit që çojnë kah pastrimi etnik dhe kah të drejtat e minoriteteve të garantuara nga sundimi i së drejtës. Raporti është esencial për të gjithë ata që janë të interesuar të kuptojnë Kosovën dhe se si të krijojnë një ardhmëri më të mirë atje, dhe gjithashtu analiza e tij mban leksione për ata që punojnë për një implementim efektiv për të drejtat e minoriteteve në një kontekst tjetër.

Punojmë për të siguruar të drejtat e minoriteteve dhe popujve vendas